

# E DREJTA PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

MANUAL



Titulli i librit: **Manual “E drejta për mbrojtjen nga diskriminimi”**

Përgatiti për botim: **Idlir PEÇI, PhD**  
**Ina XHEPA, Msc.**

Arti Grafik: Dritan LLESHI

Print:

International Standard Book Number (ISBN)

---

Ky botim u përgatit nga Fondacioni Qendra Europiane dhe u financua nga Fondacioni Konrad Adenauer Zyra për Shqipërinë. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e autorit dhe Fondacionit Qendra Europiane dhe nuk reflekton qëndrimin zyrtar të Fondacionit Konrad Adenauer.

© Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi, mbrojtur nga ligji nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, nuk mund të riprodhohet, ruhet, transmetohet a përdoret me asnjë formë a mjet grafik, elektronik apo mekanik, përfshirë por jo kufizuar fotokopje, skanime, rrejte ueb apo sisteme të tjerë pa lejen me shkrim të botuesve.

Për informacione ose komente mund të drejtoheni tek:

**Fondacioni Qendra Europiane**

Rr. Vaso Pasha,  
P. 20, Ap. 57, 1019  
Tiranë, Shqipëri  
[www.euro-centre.eu](http://www.euro-centre.eu)

**Fondacioni Konrad Adenauer**

Blv. Dëshmorët e Kombit  
Kulla Binjake 1, Kati 11, A3  
Tiranë, Shqipëri  
[www.kas.de/albanien](http://www.kas.de/albanien)

## FALËNDERIME

Manuali “E drejta për mbrojtjen nga diskriminimi” që ju paraqesim është produkt i realizimit të fazës së parë të projektit me të njëjtin emër të zbatuar nga Qendra Europiane dhe Fondacioni Konrad Adenauer, Shqipëri (KAS).

Fondacioni Konrad Adenauer ka ofruar në mënyrë të vazhdueshme mbështetje për Qendrën Europiane duke mundësuar konkretizimin e një sërë idesh në fushën e njohjes e promovimit të të drejtave të njeriut në Shqipëri, në kuadër të integritimit evropian të vendit.

Faza e dytë e projektit do të konkretizohet me veprimtari praktike në bashkëpunim me institucionet e arsimit të lartë në disa qytete të vendit për fuqizimin e kapaciteteve të studentëve në njërin anë dhe punonjësve të administratës publike në nivel vendor në anën tjetër për një njohje më të plotë të koncepteve kyç e të trajtuara gjerësisht në këtë manual, të cilat ndihmojnë në mirë zbatimin e legjisllacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

Qendra Europiane dhe KAS me anë të botimit të këtij Manuali synojnë të arrijnë një numër sa më të lartë përdoruesish e përfituesish në radhët e studentëve të së drejtës dhe shkencave shoqërore e politike, punonjësve të administratës publike qendrore e vendore, e pse jo edhe më gjerë, në radhët e qytetarëve, që synojnë të zgjerojnë njohuritë dhe të marrin një informacion sa më të përditësuar mbi të drejta dhe liri themelore e sidomos mbi të drejtën për t’u mbrojtur nga diskriminimi në ditët e sotme në Shqipëri, realitet, i cili nuk mund të kuptohet i plotë dhe i saktë pa iu referuar zhvillimeve normative dhe jurisprudencës në kuadrin e dy organizatave të rëndësishme të rajonit tonë, Këshillit të Evropës, ku Shqipëria është anëtare dhe Bashkimit Evropian, ku Shqipëria synon të anëtarësohet.

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në një shoqëri demokratike njohja, respektimi dhe garantimi i të drejtave dhe lirive të njeriut janë parakusht i domosdoshëm për zhvillimin e një jetese cilësore dhe mirëfunksionimin e shtetit të së drejtës. Nga tërësia e të drejtave dhe lirive të njeriut, në këtë Manual kemi veçuar të trajtojmë një të drejtë thelbësore, siç është e drejta për t' u mbrojtur nga diskriminimi. Historia e njerëzimit, që prej fillimit të krijimit, ka vuajtur nga diskriminimi. Sot, diskriminimi mbetet një ndër problemet më të mëdha të shumë shoqërive, qofshin këto edhe demokraci të zhvilluara. Në këtë manual do të trajtojmë mbrojtjen nga diskriminimi dhe të drejtën për informim në kushtet e risive normative dhe institucionale në Shqipëri. Ky punim shërben për të ofruar informacion dhe për të rritur ndërgjegjësimin mbi të drejtën për mbrojtjen nga diskriminimi. Njohuritë e ofruara do të shihen në spektrin kohor të së shkuarës dhe realitetit të së tashmes në Shqipëri, pa lënë mënjanë dhe kuadrin ndërkombëtar. E drejta për mbrojtjen nga diskriminimi nuk është një e drejtë statike, përkundrazi, ajo ecën paralelisht me zhvillimet politike, ekonomike dhe shoqërore, jo vetëm brenda një shteti, por edhe në nivel rajonal e global. Ndaj, duke u nisur nga nevojat aktuale në Shqipëri ku legjislati ka pësuar zhvillime të vullshme dhe e drejta për tu mbrojtur nga diskriminimi rregullohet nga një legjislacion voluminoz dhe relativisht i ri u pa e nevojshme përgatitja e këtij manuali. Legjislati kundër diskriminimit garanton mbrojtjen e grupeve të ndryshme të shoqërisë nga trajtimi i padrejtë dhe i pabarabartë për shkak të seksit, etnisë, moshës, racës, kombësisë, aftësive ndryshe, sëmundjet e shëndetit mendor, orientimit seksual, gjinisë, identitetit gjinor, fesë, besimit politik etj.

Përmes kombinimit të trajtimit teorik, analitik e vlerësues për të drejtën për mbrojtjen nga diskriminimi synojmë të përcjellim një vlerë të shtuar tek lexuesit në morinë e botimeve apo studimeve në fushën e të drejtave të njeriut.

Për më tepër, me anë të këtij Manuali, Qendra Evropiane dhe KAS dëshirojnë të paraqesin jo vetëm realitetin shqiptar, por edhe ta gërshetojë atë me zhvillimet bashkëkohore në rajon, duke iu referuar parashikimeve të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe jurisprudencës së

Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, si baza e funksionimit dhe garantimit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Evropë. Sigurisht, ka një mori botimesh, artikujsh, komentarësh për të drejtën e mbrojtjes nga diskriminimi. Kjo e drejtë do të trajtohet si nga këndvështrimi i individit nënjërinë anë, ashtu edhe shtetit pa mekanizmat e të cilit gëzimi i mbrojtjes nga diskriminimi nuk mund të bëhet i mundur. Manuali është hartuar me një stil gjuhësor të thjeshtë, në mënyrë që të mund të kuptohet edhe nga lexues të cilët nuk kanë domosdoshmërisht formim juridik. Terminologjia kyçe e përdorur është shpjeguar përpara se termat të trajtohen në referim të legjislatit, doktrinës apo jurisprudencës.

## METODOLOGJIA

Hartimi i këtij Manuali u realizua përmes hulumtimit dhe identifikimit, të materialeve përkatëse burimore, akteve normative kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut, duke u fokusuar në thelbin e temës së Manualit. Duke pasur në vëmendje një grup të gjerë lexuesish, jemi përpjekur të thjeshtojmë parashikime abstrakte, teori të mirë zhvilluara e të pasuruara të së drejtës për t'u mbrojtur nga diskriminimi, që reflektohen në praktikë. Pjesë e materialit teorik të mbledhur është edhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese shqiptare dhe rastet e trajtuara nga Komisioneri për të Mbrojtjen nga Diskriminimi, për të vijuar mbledhjen dhe përzgjedhjen e jurisprudencës së GJEDNJ-së. Manuali ka kufizimin e vet nga aspekti metodologjik. Ekzistenca dhe ushtrimi i të drejtave dhe lirive të njeriut është i vështirë të ndahet në grupime “të rëndësishme” apo “më pak të rëndësishme”. Gëzimi apo ushtrimi i një të drejte lidhet me liri apo të drejta të tjera, por fokusii këtij manuali nuk është bërja e një panorame të plotë apo shteruese të lirive dhe të drejtave të njeriut, ndaj përmbajtja paraqitet e thjeshtuar, duke synuar qartësimin e zhvillimeve aktuale në Shqipëri rreth legjisacionit dhe institucioneve përkatëse, që garantojnë të drejtën për t'u mbrojtur nga diskriminimi.

## SHKURTIME DHE AKRONIME

<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>GJK</b>	Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë
<b>GJEDNJ</b>	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
<b>DUDNJ</b>	Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut OKB
<b>Kushtetuta</b>	Ligj nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar
<b>KEDNJ</b>	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
<b>KMD</b>	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
<b>OKB</b>	Organizata e Kombeve të Bashkuara
<b>KiE</b>	Këshilli i Evropës
<b>CEDAW</b>	Konventa mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave

# Hyrje

E drejta kundër diskriminimit përbën një nga të drejtat themelore të njeriut e mbrojtur posaçërisht nga e drejta ndërkombëtare dhe kombëtare e shumë vendeve. Diskriminimi si koncept juridik dhe mekanizmat mbrojtës kundër tij janë zhvilluar përkrah zhvillimit shumëdimensional që ka pësuar vetë shoqëria drejt kahjes për të qenë më e drejtë, për të arritur një barazi sociale, mundësi të barabarta për të gjithë dhe për të garantuar barazi në ligj dhe përpara ligjit. Diskriminimi në vetvete, nënkupton trajtimin e pafavorshëm të një personi (dallim, përjashtim, kufizim, preferencë) për të gëzuar në mënyrë të njëjtë mundësitë dhe të drejtat, për shkak të karakteristikave që mbart ky person, të cilat përfshihen në “fushën e mbrojtur” nga ligji. Pra, diskriminimi nuk do të thotë trajtim i ndryshëm i personave, por diskriminim do të thotë mundësi të pabarabarta. Prandaj, legjislacioni kundër diskriminimit ndalon trajtimin e ndryshëm kur personat ndodhen në të njëjtën situatë, me qëllim që ata të mos marrin një trajtim më pak favorizues vetëm për shkak të karakteristikave të “mbrojtura” që ata zotërojnë (ky njihet si diskriminim i drejtpërdrejtë). Por legjislacioni ndalon gjithashtu trajtimin e njëjtë të personave që ndodhen në situata të ndryshme, me qëllim që këta persona të gëzojnë mundësi të njëjta si personat e tjerë (ky njihet si diskriminim i tërthortë).

## I. NDALIMI DHE MBROJTJA NGA DISKRIMINIMI NË SHQIPËRI

### 1. KUADRI LEGJISLATIV SHQIPTAR PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Në Shqipëri mbrojtja nga diskriminimi garantohet nga një hierarki normash juridike duke gjetur një mbështetje të fortë si në legjislacionin ndërkombëtar ku Shqipëria aderon, ashtu edhe në legjislacionin e brendshëm kombëtar. Përsa i përket të drejtës ndërkombëtare, mbrojtja nga diskriminimi në Shqipëri ofrohet nëpërmjet një sërë konventash në të cilat Shqipëria aderon siç është Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ)<sup>1</sup>, Konventa Ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial (1969), Konventa e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave (1981), Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës (1990), Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2008), Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës Kundër Grave dhe Dhunës në Familje etj. Përsa i përket legjislacionit të brendshëm, mbrojtja nga diskriminimi sanksionohet që në Kushtetutë<sup>2</sup>, për të vijuar me një sërë kodesh si Kodi i Procedurave Administrative<sup>3</sup> për mbrojtjen në sferën publike dhe Kodi i Punës<sup>4</sup> për mbrojtjen nga diskriminimi në marrëdhëniet e punës, si dhe sigurohet edhe nga një ligj i posaçëm për Mbrojtjen nga Diskriminimi (LMD)<sup>5</sup> dhe nga legjislacion plotësues në fusha të tjera si për shembull në fushën e mbrojtjes së personave me aftësi të kufizuara<sup>6</sup>, barazinë

<sup>1</sup> Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 14 dhe neni 1 i Protokollit 12.

<sup>2</sup> Ligj Nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 18.

<sup>3</sup> Ligj Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, neni 17.

<sup>4</sup> Ligj Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 9.

<sup>5</sup> Ligj Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

<sup>6</sup> Ligj Nr. 93, datë 24.07.2014 “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”, Ligj Nr. 7995, datë 20.09.1995 “Për nxitjen e punësimit”, i ndryshuar etj.

gjinore<sup>7</sup>, për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve<sup>8</sup>, të personave në nevojë<sup>9</sup>, të marrëdhënieve familjare<sup>10</sup>, mbrojtjen e pakicave kombëtare<sup>11</sup>, në fushën shëndetësore<sup>12</sup> etj.

Mjetet juridike për mbrojtjen nga diskriminimi realizohen nëpërmjet padisë para gjykatave dhe ankimit para Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD). Në rastet e paraqitjes së një çështje përpara gjykatës apo KMD-së, përzgjedhja e ligjit të zbatueshëm, p.sh., përfitimi nga mbrojtja që ofron KEDNJ apo ligji Për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Kodi i Punës apo ndonjë ligj tjetër, i përket palëve. Por çështja që shtrohet për diskutim në këtë rast është nëse gjykatat dhe KMD mund të zgjerohen në shkaqet që kanë çuar në diskriminim tej atyre të paraqitur nga vetë pala e interesuar. Parashikimet konkrete ligjore, por edhe praktika e deritanishme e jurisprudencës në Shqipëri ka mbajtur qëndrimin e përgjithshëm se gjykatat kryejnë vetë cilësimin e saktë të fakteve të paraqitura në gjykim pa u lidhur me përcaktimet që mund të bëjnë vetë palët. Pavarësisht kësaj gjykatat nuk mund të ndryshojnë në asnjë rast bazën ligjore të përcaktuar nga palët dhe në çdo rast ato duhet të shprehin vetëm për atë që kërkohet<sup>13</sup>. Ky qëndrim i konsoliduar i ligjit dhe i praktikës i ka dhënë të drejtë gjykatave që të mos kufizohen në argumentet e tyre dhe cilësimin e saktë të llojit të së drejtës dhe të padisë që palët pretendojnë, por ndërkohë gjykatat i përmbahen në mënyrë rigoroze ligjit të përzgjedhur dhe kërkimeve të palëve. Kuptohet që ky qëndrim i përgjithshëm është i vlefshëm edhe për rastet e gjykimit për mbrojtjen nga diskriminimi, por duke qenë se gjykatat shqiptare kanë marrë në shqyrtim shumë pak çështje për diskriminimin, është ende herët të kuptojmë nëse gjykatat do t'i japin vetes mundësinë që në zbatim të detyrimit të tyre për të "cilësuar saktë" faktet të evidentojnë edhe shkaqe të tjera diskriminimi nga ato që janë paraqitur dhe pretenduar nga palët, në ato raste kur gjykatat kanë konstatuar ekzistencën e shkaqeve të tilla dhe ligji i përzgjedhur parashikon disa shkaqe diskriminimi. Nga ana tjetër, KMD-ja paraqitet si një organ më fleksibël dhe pa ndalime të shprehura ligjore për të

<sup>7</sup> Ligj Nr. 9970, datë 24.07.2008 "Për Barazinë Gjinore në Shoqëri".

<sup>8</sup> Ligj Nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", etj.

<sup>9</sup> Ligj Nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë".

<sup>10</sup> Ligj Nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" i ndryshuar, etj.

<sup>11</sup> Ligj Nr. 96/2017 "Për mbrojtjen e pakicave kombëtare".

<sup>12</sup> Ligj Nr. 9106, datë 17.07.2003 "Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligj Nr. 10107, datë 30.03.2009 "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", Ligj Nr. 147/2014 "Për shërbimin e urgjencës mjekësore", Karta e të Drejtave të Pacientit, etj.

<sup>13</sup> Për më shumë refero nenin 6 dhe 16 të Ligjit Nr. 8116, datë 29.03.1996 "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe Vendimet Nr. 9, datë 09.03.2006; Nr. 3, datë 29.03.2012; Nr. 5 datë 30.10.2012 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

evidentuar edhe shkaqe të tjera diskriminimi nga ato të paraqitura nga vetë palët, prandaj nuk ka asnjë arsye përse ajo mos ta bëjë diçka të tillë. Madje, KMD është një organ i ngarkuar nga ligji për të nisur *ex officio* monitorime të atyre situatave ku ka indicie se mund të ketë ndodhur diskriminim. Prandaj mund të themi se KMD, si një organ promovues i barazisë që ka si funksion të saj parësor ndalimin e diskriminimit të çfarëdo lloji forme e shkakut, përveç detyrës për të shqyrtuar bazueshmërinë e shkakut të pretenduar nga palët mund të plotësojë ose ndryshojë shkaqet e diskriminimit me të tjera nga ato të paraqitura nga palët, nëse KMD evidenton se në të vërtetë ka pasur diskriminim por mbi baza e shkaqe të tjera. Në përzgjedhjen e juridiksionit në të cilin ankimi kundër diskriminimit kërkohet që të shqyrtohet rëndësi kanë edhe afatet e parashkrimit, sepse padia në gjykatë ndjek të tjera afate parashkrimi nga ankimi në KMD<sup>14</sup>.

Pra, është e rëndësishme që të kuptohen drejt mjetet dhe sistemet mbrojtëse që ofron kuadri legjislativ shqiptar kundër diskriminimit dhe mënyrën e zbatimit të tyre.

## 2. KUPTIMI I DISKRIMINIMIT DHE SHKAQET E TIJ

### 2.1 Vështrim i përgjithshëm

Në Shqipëri koncepti juridik i diskriminimit përcaktohet vetëm në Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi (LMD) dhe, duke qenë se ky ligj është përshtatur në një sërë direktivash të Këshillit dhe Parlamentit Evropian, ky koncept nuk ndryshon shumë nga ai i vendeve anëtare të Bashkimit Evropian. Konkretisht:

*Me diskriminim kuptohet çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përcaktuar nga ligji e që lidhen kryesisht me veçoritë individuale të një personi apo grup personash që qëndrojnë të pavarura dhe të pandara prej tij, dhe që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me aktet ligjore në fuqi<sup>15</sup>.*

<sup>14</sup> Për më shumë refero nenin 33 § 4, g, h dhe 36 § 1 të Ligjit Nr.10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi". Por shiko nenin 35§ 1 të KEDNJ.

<sup>15</sup> Për më shumë refero nenin 3 § 1 të Ligjit Nr.10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi".

Ky përcaktim e lidh dhe e bazon diskriminimin në shkaqe të caktuara të cilat parashikohen në mënyrë të posaçme në ligj, si p.sh., gjinia, raca, mosha, etnia, etj., që përbëjnë një tipar, karakteristikë apo status individual të personit që mbrohet nga ligji dhe që për shkak të të cilave personi që i mbart këto tipare nuk duhet të diskriminohet. Pikërisht këto karakteristika individuale të përcaktuara nga ligji, që nuk duhet të lidhen me ndonjë trajtim të ndryshëm të individit apo me gëzimin e të drejtave të tij, por që faktikisht mund të bëhen shkak për diskriminim, përbëjnë atë që quhet “*fushë e mbrojtur*”<sup>16</sup>. Fushat e mbrojtura që përcaktohen si shkaqe për diskriminim janë të ndryshme në vende të ndryshme dhe përcaktohen sipas politikave që ndjek secili vend. Përgjithësisht njihen dhe zbatohen tre modele për përcaktimin e shkaqeve diskriminuese<sup>17</sup>:

- **Modeli me ndalesë të përgjithshme:** Ky model nuk përcakton shkaqe të specifikuara diskriminimi, por bazohet në parashikimin e përgjithshëm ligjor të barazisë së të gjithë personave para ligjit. Si rrjedhojë, në vendet që ndjekin një model të tillë, janë gjykatat ato që përcaktojnë rast pas rasti shkaqet e diskriminimit. Ky model ndiqet në SHBA dhe në Kanada.
- **Modeli i mbyllur:** Sipas këtij modeli diskriminimi ndalohet për shkaqe të përcaktuara në mënyrë eksplicite nga ligji sipas një liste të mbyllur. Në këtë model gjykatat nuk mund të përcaktojnë shkaqe të tjera diskriminimi nga ato të parashikuara specifkisht në ligj dhe çdo zgjerim i fushës që mbrohet nga diskriminimi mund të bëhet vetëm me ndryshime përkatëse ligjore. Modeli i mbyllur ndiqet në vendet anëtare të Bashkimit Evropian (BE), në Britaninë e Madhe dhe në Suedi.
- **Modeli i hapur:** Në këtë model, në kontrast nga modeli i mbyllur, shkaqet e diskriminimit përcaktohen e numërohen në ligj, por duke i lënë të hapura shkaqet e listës për “çdo shkak apo status tjetër”. Pra në këtë model, gjykatat kanë liri veprimi për të përcaktuar edhe shkaqe të tjera e veçori personale diskriminimi që nuk përmenden në mënyrë specifike në listë, por që konsiderohen gjithsesi si fusha të mbrojtura nga diskriminimi për shkak se përfshihen në pjesën e hapur të listës. Ky standard zbatohet nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) dhe është një model që gjen zbatim në vendet anëtare të KEDNJ-së.

<sup>16</sup> Fundamental Rights Agency and Council of Europe. (2010). Handbook on European non-discrimination law, Luxembourg; Publications Office of the European Union, fq. 89.

<sup>17</sup> Kotevska, B. Udhëzues mbi Bazat e Diskriminimit. Shkup: Polyesterday, fq. 10.

Përveç tre modeleve të lartpërmendura, në literaturë përcaktohen edhe kriteret që duhet të plotësojnë veçoritë individuale apo shkak i diskriminimit me qëllim që ai të konsiderohet se i përket fushës së mbrojtur. Këto kriteret nuk janë kumulative. Ato shërbejnë si një mënyrë kontrolli për të përcaktuar nëse një tipar është apo jo i mbrojtur, veçanërisht në rastet kur një tipar apo status i caktuar individual nuk përmendet specifkisht në ligj si tipar i mbrojtur. Kriteret që duhet të plotësojnë veçoritë individuale të personit të cilat janë bërë shkak për diskriminim me qëllim që ato të mbrohen konsistojnë në sa vijon<sup>18</sup>:

- **Veçoria është e pandryshueshme, e pazgjdhshme dhe e pavarur nga individi:** Nëse tipari individual i personit për shkak të cilit po ndodh diskriminimi, do të mund të ndryshohej dhe në një situatë të tillë ndryshimi personi nuk do t'i nënshtrohej diskriminimit, atëherë jemi përpara diskriminimit.
- **Pjesëmarrja në proceset politike:** Nëse personi i përket një grupi me pjesëmarrje të ulët në proceset politike, veçanërisht në lidhje me aspektet që rregullon dhe mbron të drejtat e tyre, atëherë kjo mund të konsiderohet si arsye që këtij personi t'i jepet mbrojtje.
- **Dinjitet i cenueshëm:** Nëse trajtimi i pabarabartë çon në cenimin e dinjitetit të personit dhe trajtimin e tij si më pak i vlefshëm në shoqëri në dallim nga anëtarët e tjerë, atëherë personit duhet t'i sigurohet mbrojtje nga diskriminimi.
- **Historia e trajtimit të pabarabartë:** Nëse personi i përket një grupi i cili në mënyrë historike apo për një kohë të gjatë i është nënshtuar trajtimit të pabarabartë apo paragjykimeve, atëherë këtij personi duhet t'i jepet mbrojtje.

## 2.2 Fushat e mbrojtura

Në Shqipëri, shkaqet e diskriminimit janë pothuajse të ngjashme në të gjitha ligjet që ofrojnë mbrojtje nga diskriminimi siç janë për shembull

<sup>18</sup> Kotevska, B. Udhëzues mbi Bazat e Diskriminimit. Shkup: Polyesterday, fq. 10-11.

Kushtetuta<sup>19</sup>, Kodi i Procedurave Administrative<sup>20</sup>, Kodi i Punës<sup>21</sup> dhe në veçanti ligji Për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Këto ligje, kush më shumë e kush më pak parashikojnë shkaqe që janë në harmoni të plotë edhe me fushat e mbrojtura e të garantuara nga neni 14 i KEDNJ-së dhe neni 1 i Protokollit 12 të saj<sup>22</sup>. Fushat e mbrojtura nga kuadri legjislativ shqiptar dhe që përbëjnë shkak për diskriminim janë gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzënia, përkatësia prindërore, përgjegjësia prindërore, moshë, gjendja familjare ose martesore, gjendja civile, vendbanimi, gjendja shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësia e kufizuar, përkatësia në një grup të veçantë, si dhe çdo shkak tjetër<sup>23</sup>. Në veçanti theksi vihet tek fakti se shkaqet e diskriminimit të parashikuara nga legjislacioni shqiptar nuk përbëjnë një listë të mbyllur, por përkundrazi ndër këto shkaqe përfshihet çdo “shkak tjetër” që çon në diskriminim, duke qenë në harmonizim të plotë me nenin 1 të Protokollit 12 të KEDNJ-së. Kodi i Procedurave Administrative, Kodi i Punës dhe kigji Për Mbrojtjen nga Diskriminimi mbrojnë në mënyrë të shprehur “çdo shkak tjetër” që përbën bazë për diskriminim. Kurse nga ana tjetër, shkaqet e diskriminimit të parashikuara nga neni 18 i Kushtetutës shqiptare duken në pamje të parë sikur i përkasin një liste të mbyllur. Por në fakt, mbrojtja

<sup>19</sup> Neni 18 § 2 i Kushtetutës parashikon se: “Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore”.

<sup>20</sup> Neni 17 § 2 i Kodit të Procedurave Administrative parashikon se: “Organi publik, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, shmang çdo diskriminim për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, etnisë, shtetësisë, gjuhës, identitetit gjinor, orientimit seksual, bindjeve politike, fetare ose filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzënisë, përkatësisë prindërore, përgjegjësisë prindërore, moshës, gjendjes familjare ose martesore, gjendjes civile, vendbanimit, gjendjes shëndetësore, predispozicioneve gjenetike, aftësisë së kufizuar, përkatësisë në një grup të veçantë ose për çdo shkak tjetër”.

<sup>21</sup> Neni 9 § 2 i Kodit të Punës, i ndryshuar parashikon se: “Me “diskriminim” kuptohet çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim, që bazohet në gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, jetesën me HIV/AIDS, bashkimin ose përkatësinë në organizata sindikale, përkatësinë në një grup të veçantë, ose në çdo shkak tjetër, që ka si qëllim ose pasojë të pengojë ose të bëjë të pamundur ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, në të njëjtën mënyrë me të tjerët”.

<sup>22</sup> Neni 14 i KEDNJ parashikon se: “Gézimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”. Neni 1 § 1 i Protokollit 12 të KEDNJ parashikon se: “Gézimi i çdo të drejte të parashikuar nga ligji do të sigurohet pa diskriminim për shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, bindjet politike ose të tjera, origjina etnike ose sociale, shoqërimi me pakica kombëtare, pasuria, lindje ose status tjetër”.

<sup>23</sup> Për më shumë refero nenin 1 të Ligjit Nr.10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”

e të drejtave të njeriut që ofron Kushtetuta shqiptare në të njëjtin nivel me atë të KEDNJ-së, bën që Kushtetuta shqiptare të plotësojë veten e saj me “çdo shkak tjetër” që përbën bazë për diskriminim, duke ofruar të njëjtin standard mbrojtje si ajo që garanton KEDNJ-ja.

### 2.2.1 Gjinia dhe identiteti gjinor

Diskriminimi për shkak të gjinisë është një ndër shkaqet më të shpeshta të diskriminimit. Për këtë arsye ajo radhitet në fushën e mbrojtur nga ligji. Në këtë rast diskriminimi ndodh për shkak të faktit nëse personi është femër apo mashkull. Mbrojtja e kësaj fushe ka synuar të vendosë ekuilibra në aspektin ekonomik, social e politik për të eliminuar pasojat negative që sjell diskriminimi i nxitur nga ky shkak siç mund të jetë shtrembërimi i tregut të punës, jetës politike e pjesëmarrjes sociale, etj. Diskriminimi për shkak të gjinisë është vënë më tepër re tek femrat të cilat trajtohen në mënyrë më pak të favorshme se meshkujt si p.sh., pagë më e ulët për femrat që kryejnë të njëjtat detyra si kolegët e tyre meshkuj. Megjithatë nga ky lloj diskriminimi nuk janë përjashtuar as vetë meshkujt. Në këtë drejtim jurisprudenca e huaj ka pranuar se trajtimi i diferencuar në marrëdhëniet e punës që kanë për bazë gjininë nuk janë të justifikuar nëse ato bazohen në nevojat financiare apo administrative të punëdhënësit<sup>24</sup>.

Jurisprudenca shqiptare ka pasur rastin të trajtojë qoftë edhe shkarazi çështjen e diskriminimit gjinor në lidhje me llogaritjen e periudhës së sigurimit për efekt të përfimit të pensionit të pleqërisë.

**Shembull:** Me vendimin Nr. 4/2018, Gjykata Kushtetuese mori në shqyrtim kërkesën e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë për të shfuqizuar si antikueshtetues nenin 91 § 4 të Ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, e cila njeh si periudhë sigurimi për efekt llogaritje pensioni afatin e studimit të shkollës së lartë për femra, duke përjashtuar nga kjo e drejtë meshkujt. Sipas Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë neni 91 § 4 i ligjit, që trajton në mënyrë të privilegjuar femrat, pa u diktuar nga rrethana objektive dhe parimi i proporcionalitetit, bie ndesh me parimin e barazisë dhe

<sup>24</sup> Fundamental Rights Agency and Council of Europe. (2010). Handbook on European non-discrimination law, Luxembourg: Publications Office of the European Union, fq. 91.



të mosdiskriminimit të mbrojtur nga neni 18 i Kushtetutës dhe neni 14 i KEDNJ-së. Këshilli i Ministrave pretendoi nga ana tjetër se diskriminimi pozitiv që ju bëhej grave në këtë rast ishte objektivist i përligjur sepse sipas saj përfitimi i pensionit kushtëzohet nga plotësimi i dy kushteve që janë periudha e sigurimit dhe moshë. Përfitueset gra nga viti 2002 - 2023 nuk arrijnë të plotësojnë periudhën e sigurimit në momentin që mbushin moshën për pension, pa përfshirë në periudhën e sigurimit kohën e studimeve në shkollë të lartë. Pas vitit 2023, periudha e shkollës së lartë nuk do të përfshihet në periudhën e sigurimit për përfitim pensioni, sepse edhe ky kusht arrihet të plotësohet për përfitueset femra. Gjykata Kushtetuese nuk e ka vlerësuar këtë trajtim ligjor si diskriminues, por si një trajtim pozitiv që ju bëhej grave në këtë rast.

Në praktikë kanë lindur diskutime lidhur me faktin se çfarë do të kuptohet me identitetin gjinor duke pasur parasysh faktin se në dekadat e fundit shoqëria ka pësuar zhvillime domethënëse në këtë aspekt siç janë p.sh., ndryshimi biologjik i gjinisë së lindur në një tjetër, apo sjellja dhe ndjenja e një përkatësie tjetër gjinore nga ajo biologjike, etj. Prandaj ka pasur edhe tentativa për të përkufizuar domethënien e identitetit gjinor, e cila referohet si *“ndjesia e thellë e brendshme dhe përvoja individuale gjinore e çdo personi, e cila mund t'i korrespondojë ose jo gjinisë së përcaktuar në lindje, përfshirë kuptimin personal mbi trupin (që sipas zgjedhjes së lirë mund të përfshijë ndryshimet e paraqitjes trupore ose funksionale me mjete mjekësore, kirurgjikale ose mjete të tjera) dhe shprehje të tjera të gjinisë, përfshirë veshjen, mënyrën e ligjërit dhe mënyrën e sjelljes”*<sup>25</sup>. Nëse koncepti i gjinisë do të interpretohet nga jurisprudenca në kuptimin e saj abstrakt, ajo krijon disa kufizime në mbrojtjen e identitetit gjinor. Nëse jurisprudenca do të trajtojë përcaktimin e identitetit gjinor në një kuptim më të gjerë atëherë ajo përfshin personat që kanë ripërcaktuar gjininë nëpërmjet kirurgjisë (transseksualët), por edhe personat të cilët zgjedhin një mënyrë tjetër për të shfaqur gjininë e tyre si p.sh., tranvestitët ose edhe personat që vetëm përshtatin sjelljen e tyre si mënyra e të folurit, shoqërimi me gjininë e kundërt, etj<sup>26</sup>. Jurisprudenca e huaj ka pranuar si diskriminim për shkak të gjinisë edhe diskriminimin e personit për shkak

<sup>25</sup> Fundamental Rights Agency and Council of Europe. (2010). Handbook on European non-discrimination law, Luxembourg: Publications Office of the European Union, fq. 92.

<sup>26</sup> Po aty.

se ai synon t'i nënshtrohet ose i është nënshtuar ri përcaktimit të gjinisë<sup>27</sup>. Ndërkohë **jurisprudenca shqiptare nuk ka dhënë ende një përcaktim** nëse identiteti gjinor përfshihet apo jo në fushën e mbrojtur të gjinisë të përcaktuar nga ligji dhe nëse ajo përfshin transseksualët apo edhe një kuptim më të gjerë. Për më tepër, në Shqipëri rregullimet ligjore në këtë aspekt mungojnë si p.sh., mungojnë procedurat ligjore të ndryshimit të gjinisë në gjendjen civile në rastin e transseksualeve (që përfshin edhe lëshimin e letër njoftimeve, certifikatave të lindjes, etj.), mungojnë parashikimet lidhur me trajtimin ligjor të këtyre personave në lidhje me të gjitha të drejtat dhe liritë që ofron legjislati p.sh., dalja në pension e një mashkulli që ka ndryshuar gjininë në femër në të njëjtën moshë që dalin femrat, përfitimi i të drejtave nga martesë apo i një instituti ekuivalent me të, i të drejtave të njëjta si të një burri ashtu dhe të një gruaje të lidhur në martesë, etj. Megjithatë paqartësia në legjislatin në lidhje me identitetin gjinor ekziston edhe ndërmjet vendeve të BE-së. Ka disa prej tyre që e trajtojnë çështjen e “identitetit gjinor” si pjesë të “orientimit seksual” dhe ka disa vende të tjera që e trajtojnë kuptimin e saj nëpërmjet “diskriminimit gjinor”<sup>28</sup>.

## 2.2.2 Orientimi seksual

Orientimi seksual përcaktohet si mundësia e çdo personi për tërheqje të thellë emocionale, afeksioni, lidhje seksuale dhe lidhje intime me persona të një gjinie tjetër ose të së njëjtës gjini ose të më shumë se një gjinie<sup>29</sup>. Rastet tipike të diskriminimit mbi baza të orientimit seksual ndodhin kur një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme për shkak se është homoseksual<sup>30</sup> ose biseksual<sup>31</sup> si p.sh., kriminalizimi i marrëdhënieve seksuale për homoseksualët, refuzimet për të birësuar fëmijë. Ky lloj diskriminimi përjashton orientimin heteroseksual, gjë që do të thotë se një person nuk mund të pretendojë diskriminim mbi bazë të orientimit seksual me arsyetimin se është diskriminuar për shkak se është heteroseksual<sup>32</sup>.

<sup>27</sup> Po aty.

<sup>28</sup> Fundamental Rights Agency and Council of Europe. (2010). Handbook on European non-discrimination law, Luxembourg: Publications Office of the European Union, fq. 94.

<sup>29</sup> Fundamental Rights Agency and Council of Europe. (2010). Handbook on European non-discrimination law, Luxembourg: Publications Office of the European Union, fq. 97.

<sup>30</sup> Tërheqja ndodh kundrejt të njëjtës gjini.

<sup>31</sup> Tërheqja ndodh me të dyja gjinitë.

<sup>32</sup> Tërheqja ndodh ndërmjet gjinive të kundërta.

### 2.2.3 Raca, ngjyra, etnia, gjuha, përkatësia në një grup të veçantë

Legjislacione të ndryshme pasqyrojnë në mënyra të ndryshme se çfarë përfshihet në fushën e diskriminimit “racial dhe origjinës etnike”. Fusha të tilla si raca, ngjyra, etnia, gjuha e përkatësia në një grup të veçantë gjejnë mbrojtje pothuajse nga i gjithë kuadri ligjor shqiptar që ndalon diskriminimin dhe shpesh ato vlerësohen të lidhura me njëra-tjetrën. Por, në Shqipëri, me përjashtim të Kodit të Procedurave Administrative, neni 17 § 2, që e përmend shprehimisht shtetësinë si një nga fushat e mbrojtura që mund të përbëjë shkak për diskriminim, legjislacioni i brendshëm nuk e përmend shprehimisht kombësinë apo origjinën kombëtare si fushë e mbrojtur. Madje ky term me vendim të Gjykatës Kushtetuese është hequr edhe nga përmbajtja e Ligjit Nr. 10129, datë 11.05.009 “Për gjendjen civile” pasi është shpallur antikushtetues<sup>33</sup>. Termi “kombësi” nuk ka një përkufizim të përbashkët të gjithë pranuar dhe ajo herë ka shërbyer për të treguar shtetësinë, si një lidhje juridike ndërmjet shtetit dhe individit, dhe herë të tjera është përdorur për të treguar një realitet kulturor që i referohet një komuniteti që i lidh së bashku gjuha, traditat, kultura “që bazohet në bashkimin e lirë dhe të njëanshëm të një personi fizik me atë komunitet dhe përfshin vetëm marrëdhëniet ndërmjet anëtarëve të komunitetit”<sup>34</sup>. Ndërkohë, “origjina kombëtare” mund të merret për të përcaktuar kombësinë e mëparshme, të cilin personi mund ta ketë humbur ose fituar nëpërmjet natyralizimit, ose për t’ju referuar bashkëlidhjes me një “komb” brenda një shteti<sup>35</sup>. Pavarësisht mungesës në legjislacionin tonë të termit “kombësi” apo “origjinë kombëtare” si një fushë e mbrojtur, fakti që KEDNJ e përmend shprehimisht kombësinë, origjinën kombëtare dhe pjesëmarrjen në një minoritet të caktuar kombëtar si pjesë e fushës së mbrojtur, pasi sjell mbrojtjen e këtyre shkaqeve edhe në Shqipëri. Madje, në mënyrën se si jurisprudenca e GJEDNJ-së i ka trajtuar këto shkaqe, tregon se kombësia, origjina kombëtare dhe shtetësia mund të konsiderohen si element konstitutiv i etnisë. Madje, edhe ngjyra, gjuha, besimi, kultura dhe përkatësia në një minoritet kombëtar, të cilat përmenden gjithashtu shprehimisht nga GJEDNJ-ja konsiderohen si të pandashme me racën dhe etninë<sup>36</sup>. Sipas GJEDNJ-së, në mjaft raste etnia dhe raca janë dy koncepte që mbivendosen. Ndërkohë që raca i referohet

klasifikimit biologjik dhe morfologjik të njeriut si ngjyra e lëkurës ose karakteristikat e fytyrës, etnia lidhet me një grup shoqëror që identifikohet për shkak të kombësisë së përbashkët, lidhjes fisnore, besimit fetar, gjuhës ose origjinës kulturore apo tradicionale<sup>37</sup>. Sipas GJEDNJ-së diskriminimi për shkak të origjinës etnike është formë e diskriminimit racial. GJEDNJ-ja ka mbajtur një qëndrim tejet rigoroz në lidhje me diskriminimin për shkak të racës dhe etnisë duke përcaktuar se asnjë trajtim i diferencuar nuk është objektivisht i përligjur nëse ajo bazohet ekskluzivisht ose në mënyre përcaktuese vetëm në origjinën etnike<sup>38</sup>. Megjithatë në jurisprudencën e saj GJEDNJ ka ofruar qasjet e veta edhe në lidhje me trajtimin e diferencuar që bazohet tek “kombësia” apo “origjina kombëtare”. Në këtë drejtim, GJEDNJ ka përcaktuar se mungesa e lidhjeve juridike të kombësisë/shtetësisë ecën së bashku me mungesën e lidhjeve faktike me atë shtet, gjë e cila e pengon viktimën që të pretendojë se ndodhet në një situatë të krahasueshme me shtetasit e tjerë. Siç sqarohet edhe më poshtë, ndodhja në një situatë të krahasueshme me personat e tjerë është një kusht i rëndësishëm për të pretenduar se ndodhemi para diskriminimit. Sipas qasjes së GJEDNJ-së sa më tepër lidhje faktike të ketë një person me një shtet, si p.sh., personi paguan tatime dhe taksa në atë shtet, aq më pak gjasa ka që trajtimi i diferencuar mbi bazë të kombësisë të jetë i përligjur, pavarësisht mosmbajtjes së shtetësisë/kombësisë së atij shteti nga pikëpamja juridike. Në të kundërt, mungesa e lidhjeve faktike ndërmjet personit dhe shtetit, nuk e lejon viktimën që të jetë në një pozitë të krahasueshme me shtetasit e tjerë. Edhe pse shtetet gëzojnë të drejtën për të vendosur vetë mbi çështje që kanë të bëjnë me politika fiskale dhe sociale, vetëm në raste të një rëndësie të veçantë mund të përligjin diskriminimin vetëm mbi baza të shtetësisë/kombësisë, aq më tepër kur ekziston një lidhje e ngushtë faktike ndërmjet personit dhe shtetit në fjalë. Raste të diskriminimit për shkak të kombësisë/shtetësisë apo origjinës kombëtare të vërejtura nga GJEDNJ-ja ka qenë p.sh., çështjet e sigurimeve shoqërore, përfitim i pensionit, përfitim për papunësi, etj., duke mbajtur si kriter pasjen e një origjine të caktuar, çështje që lidhen me deportimin e të huajve që kanë krijuar një lidhje të fortë familjare dhe sociale me shtetin pritës, për shkak të qëndrimit për një kohë të gjatë të tyre në këtë shtet dhe kontributit me pagimin e tatim-taksave etj<sup>39</sup>.

<sup>33</sup> Vendim Nr. 52, datë 01.12.2011 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>34</sup> Refero Vendimin Nr. 52, datë 01.12.2011 të Gjykatës Kushtetuese, fq. 8 § 16; Fundamental Rights Agency and Council of Europe. (2010). Handbook on European non-discrimination law, Luxembourg: Publications Office of the European Union, fq. 107.

<sup>35</sup> Fundamental Rights Agency and Council of Europe. (2010). Handbook on European non-discrimination law, Luxembourg: Publications Office of the European Union, fq. 107.

<sup>36</sup> Fundamental Rights Agency and Council of Europe. (2010). Handbook on European non-discrimination law, Luxembourg: Publications Office of the European Union, fq. 104.

<sup>37</sup> Fundamental Rights Agency and Council of Europe. (2010). Handbook on European non-discrimination law, Luxembourg: Publications Office of the European Union, fq. 105, 106.

<sup>38</sup> Fundamental Rights Agency and Council of Europe. (2010). Handbook on European non-discrimination law, Luxembourg: Publications Office of the European Union, fq. 106.

<sup>39</sup> Fundamental Rights Agency and Council of Europe. (2010). Handbook on European non-discrimination law, Luxembourg: Publications Office of the European Union, fq. 107-109.

Në përgjithësi, diskriminimi racial është trajtuar nga institucionet ndërkombëtare, si Këshilli i BE-së dhe Komisioni i Këshillit të Evropës Kundër Racizmit dhe Intolerancës, por edhe nga Konventa e OKB-së Për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial, si dhunë ose urrejtje kundrejt një grupi për shkaqe të tilla si raca, ngjyra, besimi, gjuha, prejardhja, kombësia, shtetësia ose origjina etnike<sup>40</sup>. Komiteti Për Eliminimin e Diskriminimit Racial të OKB-së, i cili është edhe autoriteti mbikqyrës për respektimin e Konventës Për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial, ka përcaktuar se, me përjashtim kur ekziston një justifikim për të kundërtën, përcaktimi nëse një person bën apo jo pjesë në një grup të caktuar racor apo etnik do të kryhet në bazë të vetë-identifikimit të personit të diskriminuar. Kjo i pengon shtetet që të përjashtojnë nga mbrojtja ato grupe etnike të cilat ato nuk i njohin si të tilla<sup>41</sup>. Në lidhje me këtë qëndrim, Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Racial, i ka rekomanduar Shqipërisë që në censusin që është planifikuar të mbahet në vitin 2020 të respektojë parimin e vetë-identifikimit me qëllim që të sigurohet informacion i saktë mbi përbërjen etnike dhe etniko-fetare të popullsisë për të mundësuar një vlerësim më të mirë se si grupet e ndryshme që jetojnë në Shqipëri gëzojnë të drejtat e tyre sipas Konventës<sup>42</sup>. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj Nr. 52/2011 ka theksuar se personat që i përkasin pakicave kombëtare nuk mund të detyrohen të bëjnë publike përkatësinë e tyre etnike pasi kjo vjen në kundërshtim me nenin 20 të Kushtetutës për mbrojtjen e pakicave kombëtare dhe me nenin 35 të Kushtetutës, duke qenë se etnia përbën një të dhënë sensitive që i përket sferës së të dhënave private. Por ndër të tjera, Gjykata Kushtetuese sqaron në këtë vendim se:

*“Konventa Kuadër e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Minoriteteve (në vijim ‘Konventa Kuadër’), e ratifikuar nga Shqipëria, në nenin 3 të saj parashikon të drejtën e çdo personi që i përket një pakice kombëtare të zgjedhë ose të trajtohet ose të mos trajtohet si i tillë. Sipas Raportit Shpjegues të Konventës, kynën, në paragrafin 1, i garanton, së pari, çdopersoni që i përket një pakice kombëtare, lirinë për të zgjedhur për t’u trajtuarose josi të tillë. Kjo dispozitëe*

<sup>40</sup> Fundamental Rights Agency and Council of Europe. (2010). Handbook on European non-discrimination law, Luxembourg: Publications Office of the European Union, fq. 104.

<sup>41</sup> Po aty.

<sup>42</sup> Committee on the Elimination of Racial Discrimination. Concluding observations on the combined ninth to twelfth periodic reports of Albania, dated 02.01.2019, point C.7, 8, e disponueshme në: [https://tbinternet.ohchr.org/\\_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CERD/C/ALB/CO/9-12&Lang=En](https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CERD/C/ALB/CO/9-12&Lang=En), 5 mars 2019.

*lë çdo person të tillë të vendosë nëse dëshiron të bëhet subjekt i mbrojtjes që ofron Konventa Kuadër. Ky paragraf nuk nënkupton një të drejtë të individit për të zgjedhur në mënyrë arbitrare përkatësinë nëndonjëpakicë kombëtare. Zgjedhja subjektive individuale është e lidhur pazgjidhshëmrisht me kritere objektive të rëndësishme për identitetin e personit”.*

Konventa Kuadër i kushton rëndësi edhe përdorimit të gjuhës së pakicave, të cilës i sigurohet mbrojtje edhe nga neni 20 i Kushtetutës. Gjuha si kategori gëzon mbrojtje më vete në Kushtetutë dhe në legjislaionin e brendshëm vendas edhe pse siç e theksuam ajo është e lidhur me racën dhe etninë. Kur bëhet fjalë për gjuhën, rëndësi merr në veçanti arsimimi në gjuhën amtare, por edhe garantimi i të drejtave të procesit penal në gjuhën që kupton.

#### 2.2.4 Bindjet politike, fetare ose filozofike

Liria e ndërgjegjes dhe e fesë është e garantuar nga neni 24 i Kushtetutës dhe përbën një fushë të mbrojtur nga diskriminimi si nga Kushtetuta, në nenin 18 të saj ashtu edhe nga legjislaioni plotësues i brendshëm, e në veçanti ligji Për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Por edhe liria e ndërgjegjes dhe besimit fetar kufizohet në ato raste kur ushtrimi i këtyre të drejtave cenon dhe ndërhyr në të drejtat e të tjerëve dhe në veçanti në ato raste kur nëpërmjet kufizimit synohet që të mbrohen persona të tjerë nga diskriminimi. Gjithsesi edhe në këto raste kufizimi duhet të jetë proporcional me gjendjen që e ka diktuar atë. Një peshë e veçantë i është dhënë edhe qëllimeve të shteteve për të parandaluar çrregullimet dhe mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve në drejtim të ruajtjes së laicitetit e neutralitetit, sidomos kur bëhet fjalë për ndalimin e veshjeve me përmbajtje simbolike fetare, filozofike e politike në punë dhe institucionet publike, si në shkolla, administratë, spitale, etj., raste në të cilat ndërhyrja është konsideruar kryesisht e përligjur ose si kërkesë e vërtetë dhe e domosdoshme e vendit të punës, siç do të sqarohet edhe më poshtë<sup>43</sup>.

GJEDNJ-ja ka bërë të qartë se shtetet duhet të shmangin përcaktimin se çfarë përbën liri të ndërgjegjes dhe besimit fetar sepse këto liri mbrojnë jo vetëm besimtarët, por edhe çdo grup tjetër si ateistët, skeptikët, etj., që mund të kenë zgjedhur ose jo një besim fetar apo të praktikojnë një të tillë.

<sup>43</sup> Fundamental Rights Agency and Council of Europe. (2010). Handbook on European non-discrimination law, Luxembourg: Publications Office of the European Union, fq. 112-114.

Madje GJEDNJ-ja nëpërmjet praktikës së saj ka vërejtur se besimi është një kategori tejet personale dhe subjektive dhe jo domosdoshmërisht është i lidhur me një institucion të caktuar<sup>44</sup>.

GJEDNJ-ja e ka zgjeruar konceptin e “besimit” duke përfshirë në të edhe të drejtën e arsimit të përcaktuar në nenin 2, Protokollin 1 i KEDNJ-së, sipas së cilës shtetet duhet të respektojnë të drejtën e prindërve që të arsimojnë fëmijët e tyre në përputhje me bindjet e tyre fetare dhe filozofike<sup>45</sup>.

Ndërkohë, në bindjet politike dhe filozofike përfshihet gjithçka tjetër që nuk përfshihet në bindjet fetare. Bindjet politike dhe filozofike gjejnë mbrojtje si nga neni 22 § 1 i Kushtetutës lidhur me lirinë e shprehjes, ashtu edhe nga neni 24 § 1 i saj për lirinë e ndërgjegjes. GJEDNJ-ja nëpërmjet praktikës së saj ka përcaktuar se liria e shprehjes nuk mbron vetëm “informacionet” apo “idetë” që janë favorizuese ose jo fyese, por edhe ato opinione që janë fyese, shokuese ose shqetësuese për shtetin dhe popullatën<sup>46</sup>. Opinioneve dhe bindjeve politike i është dhënë një status i privilegjuar. Një rast tipik diskriminimi që mund të lidhet me këtë shkak janë p.sh., largimet nga puna për shkak të bindjeve politike, e cila gjen mbrojtje të veçantë edhe nga neni 146 i Kodit të Punës.

#### 2.2.5 Gjendja ekonomike, arsimore ose shoqërore, përkatësia prindërore, përgjegjësia prindërore, gjendja familjare ose martesore, gjendja civile, vendbanimi

Këto shkaqe janë të lidhura me njëra-tjetrën duke qenë se ato i referohen kryesisht statusit në të cilin vendoset individi si rezultat i disa veçorive të trashëguara siç janë gjendja ekonomike, shoqërore, familjare ose martesore, etj. Në disa raste, këto shkaqe shihen të lidhura edhe me racën dhe etninë. Gjendja ekonomike e individit i jep atij një status në shoqëri ose të trashëguar më anë të lindjes, si p.sh., përkatësia në një klasë të caktuar shoqërore ose komunitet të caktuar ose për shkak të situatës në të cilën ndodhet si p.sh., i pastrehë, i varfër, etj., të cilat mund të përbëjnë shkak për diskriminim. Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj 33/2007 ka përcaktuar se “Në aspektin konceptual diskriminimi për shkak “gjendje sociale” do të thotë se individët mund të diferencohen dhe

<sup>44</sup> Po aty.

<sup>45</sup> Fundamental Rights Agency and Council of Europe. (2010). Handbook on European non-discrimination law, Luxembourg: Publications Office of the European Union, fq. 113.

<sup>46</sup> Fundamental Rights Agency and Council of Europe. (2010). Handbook on European non-discrimination law, Luxembourg: Publications Office of the European Union, fq. 117.

trajtohen në mënyrë të pabarabartë bazuar në përbërjen sociale, që nuk ka lidhje me meritat e tyre”. Përkatësia prindërore, gjendja familjare, martesore ose gjendja civile përcakton statusin e fëmijës së lindur nga martesa, apo të lindur jashtë martese apo të birësuar, apo gjendja civile përcakton të drejtat e një çifti të martuar nga të drejtat e një çifti që bashkjeton, të cilat në praktikë janë bërë shkak për diskriminim. Vendbanimi gjithashtu mund të bëhet shkak diskriminimi sidomos mbi baza krahinore.

#### 2.2.6 Moshë

Moshë përbën një fushë të mbrojtur që synon të ndalojë diskriminimin, pra sjelljen më pak të favorshme në gëzimin e të drejtave të personit për shkak të moshës së tij. Në rastin e moshës një rëndësi e veçantë i jepet trajtimit të fëmijëve, sidomos në fushën e të drejtës penale të cilat duhet të jenë në përputhje me nivelin intelektual dhe psikik të moshës së fëmijës<sup>47</sup>, por edhe mbrojtjes së moshave madhorë mbi 50 vjeç siç është p.sh., në rastin e punësimit<sup>48</sup>.

#### 2.2.7 Aftësia e kufizuar, gjendja shëndetësore, predispozicione gjenetike

Kuptimi mbi aftësinë e kufizuar jepet në nenin 1 të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2008), në nenin 3 § 9 të Ligjit Nr. 93, datë 24.07.2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, por edhe në nenin 2 § 16 të Ligjit Nr. 7995, datë 20.09.1995 “Për nxitjen e punësimit”, i ndryshuar. Sipas këtyre parashikimeve ligjore, aftësi e kufizuar konsiderohet një dëmtim afatgjatë fizik, mendor, intelektual, psikologjik ose ndjesor që në ndërvëprim me pengesa të tjera, si sociale, mjedisore, infrastrukturore, institucionale, mund të vështirësojë pjesëmarrjen e plotë dhe efektive të personit në jetën sociale e profesionale në mënyrë të barabartë me të tjerët. Aftësia e kufizuar deklarohet me vendim të komisioneve mjekësore të posaçme dhe ndryshon nga paaftësia e përkohshme në punë për shkak sëmundje, e cila në Shqipëri gjen gjithashtu mbrojtje sipas Kodit të Punës<sup>49</sup>. Megjithatë, sëmundje të tilla të përhershme si p.sh., diabeti, janë konsideruar nga GJEDNJ-ja si aftësi e kufizuar<sup>50</sup>.

<sup>47</sup> Fundamental Rights Agency and Council of Europe. (2010). Handbook on European non-discrimination law, Luxembourg: Publications Office of the European Union, fq. 103.

<sup>48</sup> Refero nenin 2/20 të Ligj Nr. 7995, datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit”, i ndryshuar.

<sup>49</sup> Refero nenin 130, 147 të Kodit të Punës,

<sup>50</sup> Fundamental Rights Agency and Council of Europe. (2010). Handbook on European non-discrimination law, Luxembourg: Publications Office of the European Union, fq. 101.

Një kujdes i veçantë në drejtim të praktikës i duhet kushtuar faktit të marrjes së masave të përshtatshme që mundësojnë pjesëmarrjen efektive të personave me aftësi të kufizuara në jetën sociale dhe profesionale sepse në të kundërt do të ndodhemi përpara një diskriminimi. Marrja e këtyre masave kërkohet të kryhet në çdo institucion, si p.sh., në punë, në spitale e institucione të tjera publike e private, etj., përfshirë edhe vende të tilla si ato të mbajtjes së personave të ndaluar, arrestuar apo burgosur p.sh., marrjen e masave për tualete të përshtatshme për këto kategori personash, vendeve të posaçme që lejojnë lëvizjen e karrigeve me rrota, masa të përshtatshme fjetje, etj.

Në këtë grup është përfshirë edhe gjendja shëndetësore dhe predispozicionet gjenetike, të cilat mund të shihen të lidhura me aftësinë e kufizuar dhe gjithashtu mund të përbëjnë shkak për diskriminimin. Gjendja shëndetësore nënkupton mbartjen e një gjendje ose sëmundje të caktuar, që ndonëse nuk e kufizon aftësinë e personit për të vepruar dhe menduar, mund të bëhet shkak diskriminimi, siç është p.sh., gjendja me HIV/AIDS. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për predispozicionet gjenetike për të zhvilluar sëmundshmëri ose sindroma të ndryshme ose që e vendosin individin në një status të tillë që mund të bëhet shkak për diskriminim.

### 2.2.8 Çdo shkak tjetër

Legjislacioni shqiptar e lë të hapur listën e shkaqeve të diskriminimit edhe me “çdo shkak tjetër” që nuk përmendet në mënyrë të shprehur në ligj siç mund të jenë p.sh., anëtarësia në ndonjë organizatë, grada ushtarake, të arrestuarit në pritje të gjyqimit, etj. Në “çdo shkak tjetër” hyjnë gjithmonë ato karakteristika individuale, objektive dhe personale që e dallon individin nga personat e tjerë. Në këtë mënyrë as KMD-ja dhe as gjykatat gjatë veprimtarisë së tyre nuk kufizohen në shkaqet e diskriminimit, të cilat janë në zhvillim të vazhdueshëm kah zhvillimit shoqëror. Gjatë praktikës mund të lindin apo dalin në pah shkaqe të reja diskriminimi, të pa përmendura fare shprehimisht nga legjislacioni dhe në këtë rast këto shkaqe do të bien në sferën e “çdo shkak tjetër” duke gjetur gjithashtu mbrojtje.

## 3. LLOJET E DISKRIMINIMIT

Referuar legjislacionit shqiptar diskriminimi njihet në këto forma kryesore, në: a) diskriminim të drejtpërdrejtë; b) diskriminim të tërthortë; c) diskriminim për shkak shoqërimi; ç) shqetësimi; d) udhëzimi për diskriminim; dh) mohimi i një përshtatje të arsyeshme dhe e) viktimizimi. Këto forma të diskriminimit janë në koherencë edhe me format e tjera të diskriminimit që parashikon/ nje Bashkimi Evropian (BE) dhe KEDNJ. Secila prej këtyre llojeve të diskriminimit ka elementët e tij që i dallojnë nga njëri-tjetri. Por përveç këtyre llojeve, njihet edhe një lloj tjetër diskriminimi, më pak i trajtuar nga legjislacioni dhe më shumë i trajtuar nga jurisprudenca e organeve gjyqësore dhe *quasi* gjyqësore të vendeve të ndryshme dhe që njihet si diskriminim i shumëfishtë. Në këtë kapitull do të trajtohet me gjerë kuptimi i secilit prej këtyre llojve diskriminimesh si dhe zbatimi i tyre në Shqipëri. Fatkeqësisht jurisprudenca në fushën e diskriminimit në Shqipëri është e vakët, prandaj shembuj nga praktika të këtyre formave të diskriminimit do të jepen aty ku është e mundur.

### 3.1 Diskriminimi i drejtpërdrejtë

Forma e diskriminimit të drejtpërdrejtë parashikohet si në legjislacionin e BE-së ashtu edhe nga KEDNJ-së. Por në të njëjtën kohë edhe ligji shqiptar Për Mbrojtjen nga Diskriminimi parashikon në nenin 3 § 2 se: *“Diskriminim i drejtpërdrejtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji*.

Në përgjithësi pranohet se jemi përpara diskriminimit të drejtpërdrejtë kur<sup>51</sup>:

- (i) **Një person trajtohet në mënyrë të PAFAVORSHME:** Me trajtim të PAFAVORSHËM do të kuptojmë trajtim të ndryshëm të një personi nga të tjerët. Trajtimi i pafavorshëm në diskriminimin e drejtpërdrejtë është më lehtë i identifikueshëm sesa në rastin e diskriminimit të tërthortë, në të cilin shpesh identifikohet me anë të të dhënave statistikore. Raste të trajtimit të pafavorshëm të ndeshura në praktikë

<sup>51</sup> Fundamental Rights Agency and Council of Europe. (2010). Handbook on European non-discrimination law, Luxembourg: Publications Office of the European Union, fq. 22-26.

mund të përmendim p.sh., refuzimi i dhënies së një shërbimi publik p.sh., energji elektrike, shërbimeve mjekësore, ose i hyrjes në një restorant, pagë ose pension më i ulët, moshë më e lartë apo më e ulët për të dalë në pension, qenia objekt i dhunës verbale apo fizike, përjashtimi nga e drejta për arsim, etj.

- (ii) **në KRAHASIM me mënyrën që trajtohen të tjerët në rrethana të ngjashme:** Një trajtim i pafavorshëm do të konsiderohet se përbën diskriminim n.q.s., trajtimi është i pafavorshëm në KRAHASIM me dikë tjetër në situatë të ngjashme. Pra, që të arrijmë në konkluzionin se kemi apo jo të bëjmë me diskriminim, do të duhet domosdoshmërisht një “krahases”, i cili është një person në rrethana të njëjta, por që i vetmi ndryshim ndërmjet dy personave, qëndron tek “fusha e mbrojtur” e karakteristikave. Gjithsesi jurisprudenca jo gjithmonë e ka parë të nevojshme ta evidentojë shprehimisht “krahasesin” duke e nënkuptuar atë.

**Shembull:** Në vendimin Nr. 33/2007, Gjykata Kushtetuese mori në shqyrtim kërkesën e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë të cilat kërkonin shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të neneve 141, 143, 144, dhe 146 § 1 të Kodit të Punës me arsyetimin se këto nene shkelin parimin e barazisë, duke lejuar diskriminim për shkaqe sociale, për të cilën nuk ekziston një përligjie e arsyeshme e objektive. Sipas Kolegjeve të Bashkuara, neni 146 § 1 i Kodit të Punës e lejon punëdhënësin që, duke respektuar afatin dhe procedurën, të zgjidhë kontratën e punës për çfarëdo lloj arsye, madje edhe pa dhënë një të tillë, duke fshehur motivin e diskriminimit të përcaktuar në nenin 146 § 1. Gjykata Kushtetuese në këtë rast ritheksoi edhe njëherë nga jurisprudenca e saj se: *“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllota për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia para ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përliqet trajtim i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë”.* Prandaj në rastin në gjykim, Gjykata Kushtetuese vlerësoi se subjektet, pra punëdhënësi

dhe punëmarrësi, nuk janë në kushte objektivisht të njëjta, e për rrjedhojë të krahasueshme, por ndodhen në kushte të pabarabarta. Sipas Gjykatës Kushtetuese do të ishim në rrethanat e diskriminimit nëse *“ligjëvënësi do të bënte ndarjen e një grupi social nga të tjerët, duke trajtuar në mënyrë të disfavorshme njërin grup nga të tjerët, por brenda kategorisë së punëmarrësve”.*

- (iii) **dhe arsyeja e trajtimit të pafavorshëm është një karakteristikë e veçantë e personit (gjinia, raca, mosha, etnia, etj.) e cila përfshihet në “fushën e mbrojtur” (lidhja shkak-pasojë):** Gjithashtu, është e domosdoshme që të themi se kemi të bëjmë me diskriminim, që të ekzistojë një lidhje ndërmjet sjelljes së pafavorshme në krahasim me një person tjetër në rrethana të ngjashme, me “fushën e mbrojtur” nga ligji të karakteristikave individuale, apo edhe me një faktor që është i pandashëm nga “fusha e mbrojtur”. Por si pjesë e “fushës së mbrojtur” përfshihet edhe diskriminimi për shkak të shoqërimit, rast në të cilin personi i diskriminuar nuk është mbartës i karakteristikës së mbrojtur, por diskriminohet për shkak të shoqërimit me një person që mbart një karakteristikë të mbrojtur<sup>52</sup>. Për të arritur në përfundimin nëse kemi apo jo të bëjmë me diskriminim, duhet bërë pyetja “A do të trajtohej një person në mënyrë më pak të favorshme nëse do të kishte qenë i një tjetër gjinie, race, ngjyre, etnie, apo çdo pozicioni tjetër të kundërt nga ato të “fushave të mbrojtura”? Nëse përgjigjja do të jetë “PO” atëherë, në mënyrë të dukshme, sjellja më pak e favorshme është shkaktuar nga karakteristika që përbën “fushë të mbrojtur” nga ligji, dhe me siguri jemi përpara diskriminimit. Pra, është e domosdoshme që të krahasojmë me një person tjetër nga “viktima” e cila nuk mban karakteristikën e mbrojtur.

**Shembull:** Në vendimin e sipërcituar Nr. 33/2007 Gjykata Kushtetuese parashtrroi se diskriminimi i parashikuar nga neni 16 § 1 i Kodit të Punës duhet që të provohet në bazë të nenit 146 § 2 mbi baza të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, gjendje ekonomike, arsimore sociale apo përkatësie prindërore. Pra, diskriminimi kërkon patjetër një shkak të përcaktuar në ligj. Por ndër të tjera, Gjykata

<sup>52</sup> Për më shumë refero neni 3, pika 4 e Ligjit Nr.10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Kushtetuese u shpreh në këtë rast se: “... mund të themi se diskriminimi nuk mund të qëndrojë si motiv më vete, por duhet të jetë i lidhur ngushtësisht me ndonjë të drejtë tjetër themelore të parashikuar në Kushtetutë” duke lënë të kuptohet se diskriminimi mund të pretendohet në rast se një e drejtë tjetër kushtetuese është cenuar, e cila ka qenë rezultat i diskriminimit mbi bazë të një shkaku të mbrojtur.

**Shembull:** Në vendimin Nr. 33/2010 Gjykata Kushtetuese mori në shqyrtim shfuqizimin si antikushtetues të pikës 2 të nenit 14, si dhe nenin 27 të Ligjit nr.10142, datë 15.05.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të cilat sillnin një ulje të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shpërblimi për një kategori përfituesish. Në këtë vendim, Gjykata Kushtetuese vërejti se si në këtë rast “**ligji unifikon kushtet dhe masën e përfitimeve suplementare të disa kategorive përfituesish dhe se ky unifikim ka sjellë pasoja pozitive për një kategori përfituesish dhe pasoja negative për një tjetër kategori**, prandaj disa prej dispozitave të ligjit cenojnë të drejtat e fituara për një pjesë të ushtarakëve të Forcave të Armatosura dhe të punonjësve të Policisë së Shtetit, duke ulur masën ose kohëzgjatjen e përfitimeve të tyre” duke krijuar në këtë mënyrë diferencime të pa përligjura nga ndonjë interes publik.

### 3.2 Diskriminimi i tërthortë

Diskriminimi i tërthortë është gjithashtu një formë diskriminimi e cila njihet nga legjislati i BE, praktika e GJEDNJ-së dhe legjislati shqiptar. Konkretisht, ligji shqiptar Për Mbrojtjen nga Diskriminimi pranohet në nenin 3 § 3 se: “*Diskriminimi i tërthortë është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter apo praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte jo të favorshme, në lidhje me shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji, në raport me një tjetër person ose grup personash, si dhe kur ajo masë, kriter a praktikë, nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi, ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë*”.

Pra, diskriminimi i tërthortë ndodh për shkak të efekteve që sjell trajtimi i njëjtë që i ofrohet personave që ndodhen në situata të ndryshme e që mbartin karakteristika jo të njëjta. Përgjithësisht pranohet se jemi para diskriminimit të tërthortë kur plotësohen në mënyrë kumulative elementët e poshtëshënuara<sup>53</sup>:

(i) **ekziston një dispozitë, kriter apo praktikë neutrale apo e paanshme:** Kjo nënkupton një rregull apo praktikë që zbatohet nësej tek të gjithë personat, pa marrë parasysh diferencimet reale që ekzistojnë ndërmjet këtyre personave p.sh., një mënyrë e njëjtë llogaritje pagash apo pensionesh që sjell pabarazi të dukshme ndërmjet personave të gjinive të ndryshme.

(ii) **që ndikon negativisht në mënyrë domethënëse tek një grup që mbart karakteristika që i përkasin “fushës së mbrojtur”:** Kjo do të thotë se pavarësisht se rregulli apo praktika që zbatohet është në dukje neutrale dhe ofron trajtim të njëjtë, në realitet ajo sjell një efekt negativ domethënës duke vendosur një kategori të caktuar personash me veçori që i përkasin “fushës së mbrojtur” në një pozitë të pafavorshme. Pra, në dallim nga diskriminimi i drejtpërdrejtë, në diskriminimin e tërthortë fokusi nuk është tek trajtimi, i cili në këtë rast është i njëjtë, por zhvendoset tek efektet që trajtimi sjell. Është kjo arsyeja se përse diskriminimi i tërthortë është më i vështirë që të provohet dhe kërkon kryesisht të dhëna statistikore që tregojnë se si një praktikë apo politikë e caktuar ka ndikuar negativisht në mënyrë disproporcionale tek një kategori e caktuar njerëzish që mbartin një karakteristikë të “fushës së mbrojtur” nga ligji. Që të jemi para diskriminimit të tërthortë, duhet gjithashtu që kategoria e personave që i përkasin “fushës së mbrojtur” të përbëjnë edhe pjesën më të madhe të atyre personave që janë prekur negativisht nga rregulli apo praktika e ndjekur.

<sup>53</sup> Fundamental Rights Agency and Council of Europe. (2010). Handbook on European non-discrimination law, Luxembourg: Publications Office of the European Union, fq. 29-31.

(iii) në krahasim me persona të tjerë të ndodhur në një situatë të ngjashme: Krahasuesi në këtë rast zbatohet njësoj si në diskriminimin e drejtpërdrejtë. Krahasuesi është i rëndësishëm për të përcaktuar nëse efekti i rregullit apo praktikës së zbatuar ka qenë në mënyrë domethënëse më negative për kategorinë e personave me karakteristika të mbrojtura në krahasim me personat e tjerë në një situatë të ngjashme.

### 3.3 Diskriminim për shkak shoqërimi

Diskriminimi për shkak të shoqërimit parashikohet nga pika 4 e nenit 3 të ligjit Për Mbrojtjen nga Diskriminimi sipas së cilës: “*Diskriminim për shkak të shoqërimit*” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur ka një dallim, kufizim ose preferencë, për arsye të shoqërimit me persona që u përkasin grupeve të përmendura në nenin 1 të këtij ligji, si dhe për shkak të supozimit për një shoqërim të tillë”.

Ky lloj diskriminimi nuk ndodh për shkak të mbartjes së personit të diskriminuar të ndonjë karakteristike që i përket fushës së mbrojtur nga ligji, por ndodh për një shkak krejt tjetër që ka të bëjë me shoqërimin apo supozimin për shoqërimin e personit të diskriminuar me një person që mbart një karakteristike të mbrojtur nga ligji. Në të vërtetë ky lloj diskriminimi më tepër sesa një formë e veçantë mund të konsiderohet edhe thjesht si shkak për diskriminim.

### 3.4 Shqetësimi dhe udhëzimi për të diskriminuar

Shqetësimi dhe udhëzimi për të diskriminuar janë trajtuar fillimisht si nën forma të diskriminimit të drejtpërdrejtë, por qasja e fundit që vihet re në legjislacionin e BE-së është që ta trajtojë shqetësimin dhe udhëzimin për të diskriminuar si forma të dallueshme diskriminimi. Ndërkohë KEDNJ nuk ka parashikime ligjore specifike për ndalimin e shqetësimit dhe udhëzimin për diskriminim, megjithatë ato në disa raste janë trajtuar nga GJEDNJ nëpërmjet neneve që mbrojnë të drejta të tjera që parashikon Konventa, si p.sh., e drejta për t’u grumbulluar, e drejta për një proces të rregullt, etj në lidhje me nenin 14 për mbrojtjen nga diskriminimi<sup>54</sup>.

Edhe ligji shqiptar Për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nën të njëjtën koherencë e trajton në mënyrë të veçantë shqetësimin dhe udhëzimin për

<sup>54</sup> Fundamental Rights Agency and Council of Europe. (2010). Handbook on European non-discrimination law, Luxembourg: Publications Office of the European Union, fq. 34-35.

të diskriminuar. Konkretisht sipas nenit 3 § 5 të ligjit Për Mbrojtjen nga Diskriminimi: “*Shqetësim*” është ajo formë e diskriminimit që ndodh në rastin e një sjelljeje të padëshiruar, kur lidhet me cilëndo nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, që ka për qëllim apo efekt cenimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, përcmues, poshtërues a ofendues për atë person, si dhe në rastin e një trajtimi më pak të favorshëm, i kryer si rezultat i kundërshtimit ose i mosnënshtrimit nga ana e personit të cenuar ndaj një sjelljeje të tillë”.

Duke u nisur edhe nga përcaktimet ligjore, përgjithësisht pranohet se shqetësimi do të konsiderohet diskriminim nëse<sup>55</sup>:

- (i) kryhet një sjellje e padëshiruar që lidhet me një nga shkaqet apo karakteristikat e mbrojtura nga ligji;
- (ii) me qëllimin apo që ka si pasojë cenimin e dinjitetit të personit;
- (iii) dhe/ose të krijojë një mjedis frikësues, armiqësor, përcmues, degradues, poshtërues dhe fytes për personin;
- (iv) dhe/ose trajtim më pak të favorshëm për personin që kundërshton t’i nënshtrohet një sjelljeje të tillë

Shqetësimi karakterizohet nga elementë objektivë siç është p.sh., sjellja konkrete ndaj viktimës apo trajtimi më pak favorizues i tij, por edhe nga elementë subjektivë që lidhen posaçërisht me preceptimin e vetë viktimës kundrejt trajtimit që vlerësohet prej tij si shqetësues. Në rastin e shqetësimit nuk ka nevojë për një krahasues me qëllim provueshmërinë e saj duke qenë se shqetësimi në vetvete konsiderohet i papranueshëm për shkak të formës së saj nëpërmjet përdorimit të dhunës verbale, jo verbale apo fizike si dhe pasojave që ajo sjell në cenimin e dinjitetit të personit.

Në lidhje me udhëzimin për të diskriminuar, neni 3 § 6 i ligjit Për Mbrojtjen nga Diskriminimi parashikon se: “*Udhëzim për të diskriminuar*” është një udhëzim ose kërkesë, bazuar në marrëdhënie hierarkike, për të diskriminuar një ose më shumë persona, në bazë të shkaqeve të përmendura në nenin 1 të këtij ligji”. Udhëzimi për të diskriminuar përbën diskriminim. Një udhëzim përbën diskriminim nëse ai nuk është i detyruar për t’u dhënë, por përbën një preferencë ose inkurajim për të trajtuar një person në mënyrë të pafavorshme për shkak të karakteristikave të veçanta të mbrojtura që mbart personi i diskriminuar.

<sup>55</sup> Fundamental Rights Agency and Council of Europe. (2010). Handbook on European non-discrimination law, Luxembourg: Publications Office of the European Union, fq. 31.



### 3.5 Mohimi i një përshtatje të arsyeshme dhe veprimet pozitive

Sipas pikës 7 të nenit 3 të ligjit Për Mbrojtjen nga Diskriminimi: *“Mohimi i një përshtatjeje të arsyeshme” është ajo formë diskriminimi që ndodh kurdoherë kur ka një mohim ose kundërshtim për të kryer ndryshime ose rregullime të domosdoshme e të përshtatshme që nevojiten në një rast të veçantë dhe nuk imponojnë një barrë të tepruar, me qëllim që të sigurohet gëzimi dhe ushtrimi në baza të barabarta i të drejtave dhe lirive themelore për personat me aftësi të kufizuara, ose të ndodhur në kushtet e tjera të përmendura në nenin 1 të këtij ligji*. Përmbajtja e këtij neni, plotësohet edhe nga parashikimet e nenit 11 të ligjit që kërkon marrjen e “veprimeve pozitive” apo “masave të përkohshme, të veçanta” që synojnë *“përshejtimin e vendosjes reale të barazisë, kur mungesa e barazisë është shkaktuar nga diskriminimi për çdo shkak”* të parashikuara nga ligji. Këto veprime pozitive nuk përbëjnë diskriminim dhe ndërpriten *“sapo të jenë arritur objektivat e trajtimit dhe ofrimit të mundësive të barabarta”*. Në të kundërt, mos marrja e këtyre masave të nevojshme pozitive përbën diskriminim.

Në rastin e mohimit për një përshtatje të arsyeshme personi i diskriminuar është mbartës i një prej karakteristikave të mbrojtura nga ligji si p.sh., aftësitë e kufizuara, gjinia, raca, etnia, etj. Por në këtë rast diskriminimi nuk ka si shkak primar karakteristikën që mbart individi por mos marrjen e masave të nevojshme për të lejuar një trajtim të barabartë edhe për këta persona, p.sh., në një godinë ku formalisht lejohet lirisht dhe nuk pengohet hyrja e personave me aftësi të kufizuara, por në të cilën nuk janë marrë masa teknike të tilla që lejojnë hyrjen e këtyre siç mund të jenë p.sh., ashensorët e posaçëm, apo vendet e parkimit për personat me aftësi të kufizuara, etj. Pra, në këtë rast diskriminimi shfaqet në mënyrë të tërthortë për shkak të zbatimit njësoj të të njëjtit rregull duke mos mbajtur parasysh diferencimet që kanë personat. Prandaj për të parandaluar dhe eliminuar diskriminimin e krijuar nga këto diferenca duhet të merren masa të veçanta që do të rregullonin dhe mundësonin shance të barabarta edhe për personat që ndodhen në një situatë ndryshe sesa thjesht një “barazi formale”<sup>56</sup>. Siç mund të kuptohet, ky lloj diskriminimi më tepër paraqitet si shkak për diskriminim sesa si një formë e posaçme e saj.

Në disa raste “veprimet pozitive” apo “masat e veçanta” nënkuptojnë edhe privilegjet apo masat e përkohshme, proporcionale që jepen për një kategori të caktuar personash të cilat janë subjekt diskriminimi me qëllim për

<sup>56</sup> Fundamental Rights Agency and Council of Europe. (2010). Handbook on European non-discrimination law, Luxembourg: Publications Office of the European Union, fq. 35.

të arritur pozicionimin e këtyre personave në një status më të barabartë në raport me pjesën e pa diskriminuar, p.sh., masat e përkohshme të marra nga një punëdhënës duke i ofruar punën një gruaje dhe jo një burri me qëllim që të arrihet një përfaqësim i barabartë i të dy gjinive në punësim<sup>57</sup>. Këto lloj masash ndërpriten sapo arrihet qëllimi për të cilën ato janë ndërmarrë. Në këtë rast “veprimet pozitive”, edhe pse përbëjnë një trajtim të diferencuar nuk shihen si një formë diskriminimi, por si një përjashtim nga ndalimi për diskriminim<sup>58</sup>.

### 3.6 Viktimizimi

Pika 8 e nenit 3 të ligjit Për Mbrojtjen nga Diskriminimi parashikon se: *“Viktimizimi” është trajtim i disfavorshëm apo pasojë negative, që vjen si reagim ndaj një ankimi a një procedimi që synon zbatimin e parimit të barazisë*”.

Më tepër sesa një formë e veçantë diskriminimi, viktimizimi përbën më tepër një shkak për diskriminim si rrjedhojë e një ankimi apo procedimi të mëparshëm për mbrojtjen nga diskriminimi, p.sh., një punonjës që ankohet tek punëdhënësi i tij për pabarazi në pagë për shkak të gjinisë, ankimi i cili nga ana e tij mund të jetë bërë shkak për trajtim të pabarabartë të ankuesit në të drejta të tjera në punësim si p.sh., përjashtimi i tij nga proceset trajnuese ose promovuese, etj. Prandaj viktimizimi shoqërohet shpesh edhe me shkaqe të tjera diskriminimi duke çuar në diskriminim të shumëfishtë, sikurse do të trajtohet më poshtë. Në Shqipëri KMD ka trajtuar raste të viktimizimit pikërisht duke e parë atë të lidhur me shkaqe të tjera diskriminimi, shembuj të praktikave të së cilës jepen pikërisht tek seksioni i diskriminimit të shumëfishtë të këtij manuali.

### 3.7 Diskriminimi i shumëfishtë

Diskriminimi i shumëfishtë nuk përmendet nga legjislati shqiptar. Ndërkohë, legjislati i BE-së ofron parashikime lidhur me diskriminimin e shumëfishtë ndonëse në mënyrë të vakët. Diskriminimi i shumëfishtë nënkupton diskriminimin që ndodh për më shumë se një shkak të vetëm, prandaj edhe pasojat që sjell ky lloj diskriminimi janë kryesisht më rënda. Në teori njihen këto forma të diskriminimit të shumëfishtë<sup>59</sup>:

<sup>57</sup> Fundamental Rights Agency and Council of Europe. (2010). Handbook on European non-discrimination law, Luxembourg: Publications Office of the European Union, fq. 37.

<sup>58</sup> Refero nenin 6 i Ligjit Nr.10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Fundamental Rights Agency and Council of Europe. (2010). Handbook on European non-discrimination law, Luxembourg: Publications Office of the European Union, fq. 38.

<sup>59</sup> Anastasi, A. (2017). Diskriminimi i Shumëfishtë dhe Roli i Avokatit në Adresimin e tij, Avokatia, Nr. 21, Tiranë: Dhoma Kombëtare e Avokatisë, fq. 12-14.

- (i) **Diskriminim i shumëfishtë:** Nënkupton diskriminimin që kryhet në raste të ndryshme për më shumë se një shkak, ku shkaqet qëndrojnë në mënyrë të pavarur nga njëra tjetra, p.sh., një grua e besimit mysliman mund të pësojë diskriminim për shkak të besimit të saj në një rrethanë të caktuar, p.sh., në mundësinë për arsim dhe mund të pësojë diskriminim për shkak të gjinisë së saj në një rrethanë tjetër p.sh., në punë duke marrë pagë më të ulët.
- (ii) **Diskriminim i përbërë:** Nënkupton diskriminimin që pëson personi në një situatë të vetme për më shumë se një shkak, kur shkaqet janë të pavarura dhe veprojnë në të njëjtin kohë, ose kur një shkak i ri diskriminues i shtohet shkakut të mëparshëm, p.sh., një person mund të diskriminohet gjatë marrjes së tij në punë për shkak të moshës dhe përkatësisë së tij etnike, duke ulur në mënyrë të ndjeshme shancet e tij për t'u rekrutuar.
- (iii) **Diskriminim i ndërthurur ose ndër sektorial:** Nënkupton diskriminimin që pëson një person në një situatë të vetme për më shumë se një shkak që veprojnë njëkohësisht, kur shkaqet janë të kombinueshme dhe të ndërthurura me njëra-tjetrën në mënyrë të pandashme, p.sh., një grua shtatzënë mund të diskriminohet gjatë marrëdhënieve të punës për shkak të shtatzënisë së saj duke mos u promovuar për një vend të caktuar dhe mund të diskriminohet njëkohësisht për shkak të gjinisë së saj duke pasur një pagë më të ulët.

Pavarësisht faktit se diskriminimi i shumëfishtë nuk përmendet nga legjislacioni shqiptar, kjo formë diskriminimi është trajtuar në mënyrë spontane nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) gjatë shqyrtimit të ankesave që janë paraqitur për zgjidhje para tij. Më poshtë do të referohen një sërë vendimesh ku KMD-ja ka evidentuar raste të diskriminimit të shumëfishtë<sup>60</sup>:

**Shembull:** Në vendimin Nr. 11/2012, kërkesja ka pretenduar diskriminim për shkak të gjinisë, si dhe viktimizim për shkak të denoncimit që kërkesja u ka bërë drejtuesve të institucionit për veprimtari korruptive. Ky pretendim është pranuar plotësisht nga KMD-ja, i cili në vendimin e tij ka konstatuar ekzistencën e diskriminimit për shkak të gjinisë, si dhe të viktimizimit për shkak të denoncimeve të kryera.

**Shembull:** KMD inicion *ex officio* çështjen “Për monitorimin e shpërndarjes së nxënësve romë në shkollat 9-vjeçare në Tiranë”, me prezumimin se mund të kishte ndodhur diskriminim në këtë shkollë për shkak të etnisë, racës e gjuhës. KMD ishte vënë në dijeni të një informacion sipas të cilit një grup nxënësish të komunitetit rom ishin regjistruar të gjithë së bashku në të njëjtën klasë të pare të shkollës 9-vjeçare “Bajram Curri”, në Tiranë. Në këtë rast, KMD-ja nuk ka argumentuar se përse e ka iniciuar çështjen për të tria shkaqet, por duket qartë se KMD ka prezumuar tre shkaqet të mundshme të lidhura natyrisht me njëra-tjetrën, siç janë etnia, raca dhe gjuha.

**Shembull:** Në vendimin Nr. 93 dhe 94/2013 të KMD, kërkesja, pas zgjidhjes së martesës, jeton në një apartament me dy vajzat e saj dhe bashkëjetuesin, me të cilin presin edhe një fëmijë, pasi ajo është shtatzënë në muajin e nëntë. Ajo është në proces gjyqësor për pjesëtimin e pasurisë bashkëshortore me ish-bashkëshortin nga martesa, pjesë e të cilit është edhe apartamenti ku ajo banon. Por, prej 5 vjetësh ajo ka paguar të gjitha detyrimet financiare në bazë të kontratave për furnizimin me energji dhe ujë që janë lidhur midis ndërmarrjeve përkatëse dhe ish-bashkëshortit. Papritur furnizimi me energji dhe ujë ndërpriten pa asnjë njoftim, pasi ish-bashkëshorti kërkoi në mënyrë të njëanshme zgjidhjen e kontratës me këto ndërmarrje. Kërkesja kërkoi të lidheshin kontratat me atë vetë, pasi dëshmoi se ajo i

<sup>60</sup> Rastet referuar në këtë pjesë janë paraqitje motamo të rasteve të identifikuar në studimin: Anastasi, A., dhe Bozo, A., etj. (2016). Diskriminimi i shumëfishtë dhe mekanizmat ligjorë për parandalimin e tij (Legjislacioni, praktika dhe roli i organizatave jofitimprurëse), Tiranë: Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, i aksesuar në 19 Shkurt 2019: [http://www.qag-al.org/publikime/diskriminimi\\_shumefishte.pdf](http://www.qag-al.org/publikime/diskriminimi_shumefishte.pdf).

kishte të gjitha aftësitë paguese, por kërkesa e saj u refuzua. Për më tepër, kompania CEZ e shpërndarjes së energjisë i kërkoi vendim gjykatë për të lidhur një kontratë në emër të saj.

#### 4. LEJIMI I TRAJTIMIT TË DIFERENCUAR

Çdo lloj forme diskriminimi, për çfarëdo lloj shkak, përfshirë edhe mos marrjen në shqyrtim të ankesave dhe procedimeve kundër diskriminimit si dhe mos marrjen e masave të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara është e ndaluar sipas ligjit shqiptar<sup>61</sup>. Por megjithatë ka edhe raste përjashtimore nga ky ndalim i përgjithshëm në të cilat trajtimi i ndryshëm lejohet. Përjashtime të tilla njihen jo vetëm nga legjislati shqiptar<sup>62</sup>, por edhe nga KEDNJ dhe legjislati i BE-së<sup>63</sup>. Në Shqipëri, këto lejime përjashtimore janë të përgjithshme për çdo formë diskriminimi, por edhe të veçanta.

##### 4.1 Lejimi i përgjithshëm

Neni 17 i Kushtetutës së RSH parashikon se:

*“1.Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.  
2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.*

Në po të njëjtën linjë ecën edhe parashikimi i nenit 18 § 3 të Kushtetutës kur parashikon se: *“Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive”.*

<sup>61</sup> Për më shumë refero nenin 5 dhe 7 të Ligjit Nr.10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

<sup>62</sup> Për më shumë refero nenin 6 të Ligjit Nr.10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

<sup>63</sup> Për më shumë refero Fundamental Rights Agency and Council of Europe. (2010). Handbook on European non-discrimination law, Luxembourg: Publications Office of the European Union, fq. 43.

Ndërkohë sipas nenit 6 § 1 të ligjit Për Mbrojtjen nga Diskriminimi: *“Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në raste kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislati në fuqi”.*

Pra, ligji lejon përjashtime sipas të cilave trajtimi në mënyrë të ndryshme është i përligjur. Me qëllim që të jemi para një trajtimi ndryshëm të përligjur duhet që<sup>64</sup>:

- (i) ndërhyrja në të drejtën dhe kufizimi i saj duhet të bëhet vetëm me ligj;
- (ii) trajtimi i ndryshëm të ketë një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur, siç është interesi publik apo mbrojtja e të drejtave të të tjerëve;
- (iii) mjetet e përdorura për të arritur këtë qëllim (dhe që kanë sjellë trajtim të ndryshëm) duhet të jenë proporcionale dhe të nevojshme për të arritur këtë qëllim.

Me qëllim që trajtimi i ndryshëm të jetë i përligjur dhe proporcional duhet të arrihet në përfundimin se<sup>65</sup>:

- (i) nuk ka asnjë mjet tjetër për të përmbushur qëllimin që e cenon më pak trajtimin e barabartë, duke sjellë pabarazinë më të vogël të mundshme për palën e dëmtuar të nevojshme për të arritur qëllimin e kërkuar; dhe
- (ii) qëllimi që kërkohet të arrihet është mjaftueshëm i rëndësishëm për të justifikuar këtë shkallë cenimi të barazisë.

**Shembull:** Në vendimin Nr. 20/2006, Gjykata Kushtetuese mori në shqyrtim kushtetutshmërinë e një sërë aktesh normative, vendime të Këshillit të Ministrave, të cilat synonin që të vendosnin rregulla mbi shmangien e nepotizmit në institucionet e administratës publike. Grupet e interesuara që e kishin paraqitur çështjen para Gjykatës Kushtetuese pretendonin ndër të tjera se në rastin konkret, 3 vendimet e Këshillit të Ministrave që kundërshtoheshin kishin kufizuar

<sup>64</sup> Refero edhe Fundamental Rights Agency and Council of Europe. (2010). Handbook on European non-discrimination law, Luxembourg: Publications Office of the European Union, fq. 44.

<sup>65</sup> Po aty fq. 45.

të drejtat e njeriut të parashikuara në Kushtetutë, pa ligj të Kuvendit, duke shkelur parimin e barazisë para ligjit, parimin e mosdiskriminimit si dhe të drejtën e punonjësve për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme. Sipas pretendimeve të palës kërkuese, Këshilli i Ministrave nuk është i ngarkuar me nxjerrjen e akteve nënligjore për të kufizuar të drejtat e shtetasve dhe se vetëm Kuvendi mund të vlerësojë nëse për shkak të një interesi publik ose mbrojtjes së të drejtave të të tjerëve, mund të kufizohen të drejtat e individit. Gjykata Kushtetuese në lidhje me këtë aspekt vlerësoi se termi "vetëm me ligj" i përcaktuar në nenin 17 të Kushtetutës interpretohet në mënyrë të ngushtë dhe nuk nënkupton çdo lloj akti normativ, por vetëm ligjin e nxjerrë nga Kuvendi pasi sipas Gjykatës: *"Duke iu referuar përmbajtjes së nenit 17 të Kushtetutës, ... kjo dispozitë, në mënyrën se si është formuluar, nuk i ka lënë mundësi delegimi ndonjë organi tjetër përveç Kuvendit si organ përfaqësues"*. Për më tepër që në rastin konkret bëhet fjalë për kufizime të të drejtave kushtetuese. Në këtë vendim, Gjykata Kushtetuese u shpreh edhe se me qëllim që të arrihet parimi i proporcionalitetit *"nga të gjitha mjetet e ndryshme që mund të shfrytëzohen për të arritur një qëllim të ligjshëm, autoriteti administrativ duhet të përdorë mjetet ligjore më tëpërshtatshme, me të cilat mund të arrihet në shkaktimin e padrejtësisë më të vogël për individin. Prandaj, duhen përdorur vetëm mjetet që shkaktojnë padrejtësinë minimale për individin dhe me sa më pak masa të dëmshme për të"*, duke ruajtur një përpjesëtim të arsyeshëm të mjetit të përdorur dhe qëllimit që kërkohet të arrihet.

**Shembull:** Edhe në vendimin Nr. 60/2016, Gjykata Kushtetuese i kushton rëndësi respektimit të parimit të proporcionalitetit dhe përdorimit të mjeteve që sjellin dëmtimin më të vogël. Në këtë rast, Dhoma Kombëtare e Avokatisë ka kërkuar shfuqizimin si antikushtetues të një ndryshimi ligjor në ligjin për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore i cili sipas saj cenonte parimin e barazisë dhe të mosdiskriminimit, sepse norma ligjore në këtë rast vendoste kritere diskriminuese për

përcaktimin e kufizimit minimal dhe maksimal të pagës për efektet të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, duke mbajtur për bazë jo të ardhurat e realizuara por llojin e profesionit, zonën ku zhvillohet aktiviteti ekonomik, nivelin e të ardhurave, eksperiencën në profesion dhe statusin e profesionit. Sipas kërkuesit kjo krijonte trajtim të diferencuar ndërmjet subjekteve që ushtronin veprimtari profesionale dhe atyre që ushtronin veprimtari joprofesionale, për të cilët si bazë merret paga minimale dhe maksimale në shkallë vendi dhe jo një pagë që do të përcaktohet sipas diskrecionit të Këshillit të Ministrave si në rastin e veprimtarive profesionale. Trajtim të diferencuar kishte edhe në raport me të punësuarit në aspekt të përfitimeve nga skema e sigurimeve, pasi subjektet e veprimtarive profesionale kishin përfitime në më pak zëra. Gjykata Kushtetuese në këtë rast ka theksuar se: *"Jurisprudenca kushtetuese ka përcaktuar disa standarde për të vlerësuar nëse një ligj është diskriminues bazuar në kushtet dhe kriteret e nenit 18 të Kushtetutës. Në të tilla raste, Gjykata shqyrton nëse ligji parashikon trajtim të diferencuar të subjekteve dhe në rast se e konstaton këtë fakt, ajo vlerëson nëse diferencimi ka qenë i përligjur dhe për një arsye objektive. Kjo përligje vlerësohet e lidhur me qëllimet dhe efektet e masave të marra. Gjithashtu, nuk mjafton vetëm diferencimi i përligjur, por edhe që mjeti i përzgjedhur për arritjen e qëllimit të ligjvënësit të jetë i arsyeshëm dhe i përshtatshëm"*. Më tej Gjykata thekson se: *"Përdorimi i këtyre mjeteve duhet të jetë i domosdoshëm, gjë që do të thotë se synimi nuk mund të arrihet me mjete të tjera. Domosdoshmëria ka të bëjë, gjithashtu, edhe me përdorimin e mjeteve më pak të dëmshme për subjektet që u cenohen të drejtat dhe liritë"*.

**Shembull:** Në vendimin Nr. 17/2010, Gjykata Kushtetuese ka marrë në shqyrtim përputhshmërinë me Kushtetutën të një sërë aktesh ligjore që lejonin Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme që të fshinte nga regjistri titujt e pronësisë që krijojnë mbivendosje me tituj të mëparshëm dhe që nuk rridhnin nga njëri-tjetri. Në këtë rast, Gjykata vlerësoi se edhe pse ekziston një interes publik që synon

rikthimin e ligjshmërisë së situatës së pronave, ndërhyrjet në këtë rast nuk janë të përshtatshme dhe proporcionale me dëmin që i shkaktohet individit nga kjo ndërhyrje dhe shteti ka mundësi të tjera për të arritur qëllimin e kërkuar. “Shteti, brenda mundësive, duhet të kufizojë ndërhyrjen në minimum, duke kërkuar zgjidhje alternative dhe, përgjithësisht, duke u përpjekur t’i arrijë qëllimet në mënyrë sa më pak të dëmshme nga pikëpamja e të drejtave të njeriut”. Sipas Gjykatës, edhe pse fshirja e regjistrimit nuk e zhvesh titullarin nga e drejta e pronësisë, ajo i kufizon atij të drejtën për të disponuar e gëzuar pronën për një afat të pacaktuar, duke mos krijuar një balancë ndërmjet interesit publik dhe të drejtës së cenuar. Mjeti i përdorur në këtë rast është sipas Gjykatës jo proporcional.

Këto përjashtime të përgjithshme lejohen për çfarëdo lloj diskriminimi, por sidomos ato vihen re në rastet e politikave sociale të cilat janë të shoqëruara me efekte fiskale dhe financiare, ku shteti nën diskrecionin e tij e përcakton vetë nëse ka një arsye të përligjur për të pasur një trajtim të ndryshëm të personave.

**Shembull:** Në vendimin Nr. 2/2013, Gjykata Kushtetuese u shpreh se edhe pse akti normativ që atakohej në këtë rast krijonte ndërhyrje në të drejtën e përfitimit të pensionit të parakohshëm të ushtarakëve, ndërhyrja në këtë rast ishte në përputhje me kufizimet e vendosura nga neni 17 i Kushtetutës pasi ndërhyrja në llogaritjen e pensionit të parakohshëm për vjetërsi është bërë me ligj, ka qenë e diktuar nga një interes publik si “a) efekti i papërballueshëm për buxhetin e shtetit; b) reduktimi i borxhit publik; c) presioni negativ i krizës globale financiare; ç) konsolidimi fiskal i qeverisë; d) funksionimi normal i skemës së sigurimeve shoqërore; dh) natyra e sigurimit shoqëror suplementar”, ndërhyrja ka qenë e arsyeshme dhe në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë, si dhe nuk ka prekur thelbin e së drejtës. Në këtë rast Gjykata Kushtetuese vlerësoi gjithashtu se: “natyra e sigurimit shoqëror suplementar është e ndryshme nga sigurimi shoqëror bazë, pasi qëllimi i të parit është shmangia e pasojave negative në ushtrimin e

funksionit të një kategorie të caktuar të punonjësve, si dhe garantimi e ruajtja e të ardhurave për sigurimin e nevojave jetike të tyre”. Prandaj Gjykata Kushtetuese konkludoi se: “ndryshimi i skemës së përfitimeve suplementare mbetet në **diskrecion të politikave** dhe mundësive të ekzekutivit, kurse **prekja e skemës së sigurimeve shoqërore bazë nuk duhet kurrësi të pësojë ndryshime të tilla që të përkeqësojë ndjeshëm jetën e shtetasve që përfitojnë këtë sigurim**”. Është pikërisht kjo arsyeja se përse Gjykata në këtë rast konkludoi se ndërhyrja në skemën e sigurimeve suplementare ose të parakohshme, e cila sillte uljen e pensionit, është e justifikuar dhe respekton parimin e proporcionalitetit për mbrojtjen e interesit publik, atë të mirëfunksionimit të buxhetit publik, “i cili do të pësonte goditje të konsiderueshme nëse nuk bëhej ndërthurja në skemën e pensioneve të parakohshme”.

## 4.2 Lejimi për raste të veçanta

Përveç lejimeve të përgjithshme, ka edhe disa raste të veçanta e të përcaktuara në të cilat legjislati shqiptar e lejon trajtimin e ndryshëm. Një nga këto raste të veçanta, të parashikuara nga legjislati shqiptar, në të cilat trajtimi i ndryshëm është i justifikuar ka të bëjë me “kërkesat e vërteta e të domosdoshme profesionale”. Kurse tjetra ka të bëjë me lejimin e diskriminimit për shkak të ndërgjegjes dhe fesë kur ekziston një “përligjeje e arsyeshme dhe objektive”. Gjithsesi, këto lejime të diskriminimit duke qenë se janë përjashtime, duhet të interpretohen nga gjykatat dhe KMD në mënyrë sa më të ngushtë sikurse është vepruar edhe nga jurisprudenca e huaj<sup>66</sup>, pasi në të kundërt ato mund të cenojnë të drejtat kushtetuese të individit.

### 4.2.1 Diferencim për shkak të “kërkesave të vërteta e të domosdoshme profesionale”.

Sipas nenit 6 § 2 i ligjit Për Mbrojtjen nga Diskriminimi:

*“Trajtimi i ndryshëm që bazohet në një karakteristikë të lidhur me shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, nuk*

<sup>66</sup> Për më shumë refero Fundamental Rights Agency and Council of Europe. (2010). Handbook on European non-discrimination law, Luxembourg: Publications Office of the European Union, fq. 46.

*përbën diskriminim kur për shkak të natyrës së aktiviteteve profesionale, ose të kushteve në të cilat profesioni ose veprimtaria ushtrohet, këto karakteristika përbëjnë një kërkesë të vërtetë dhe profesionale të domosdoshme, me kusht që qëllimi i trajtimit të ndryshëm të jetë i përligjur dhe kërkesa të mos kapërcejë atë çfarë është e domosdoshme për realizimin e saj”.*

Ky përjashtim i lejon punëdhënësit që të bëjnë trajtim të diferencuar të punonjësve të tyre bazuar në një nga karakteristikat e mbrojtura nga ligji, si p.sh., gjinia, kur kjo karakteristikë ka lidhje me aftësinë për të kryer punën dhe kërkesat profesionale të saj, p.sh., kur kërkohet të punësohet një femër në një kor femëror, ose një gardian mashkull në një burg burrash, etj.

#### 4.2.2 Diferencim për shkak të ndërgjegjes dhe fesë

Neni 10 § 2 i ligjit Për Mbrojtjen nga Diskriminimi parashikon se:

*“Përjashtimi nga kjo dispozitë mund të lejohet vetëm kur ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive. Megjithatë, në çdo rast, lejimi i diskriminimit për shkak të ushtrimit të lirisë së ndërgjegjes dhe fesë mund të vendoset vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Përjashtimi për këtë shkak duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar nevojën për diskriminim. Në çdo rast lejimi i diskriminimit për shkak të ushtrimit të lirisë së ndërgjegjes dhe fesë nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.*

Edhe pse ligji e parashikon lejimin e diskriminimit mbi bazën e ndërgjegjes dhe fesë me një dispozitë të veçantë, ajo nuk ndryshon shumë nga lejimi i përgjithshëm i diskriminimit për shkaqe të tjera. Edhe në këtë rast, lejimi i këtij diskriminimi kërkon që:

(i) të ekzistojë një qëllim i arsyeshëm dhe objektiv siç është interesi publik dhe mbrojtja e të drejtave të të tjerëve. Ky qëllim duhet gjithashtu të jetë i përligjur, pasi një lejim i tillë diskriminimi mund të bëhet vetëm me ligj;

(ii) diskriminimi të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë për të arritur qëllimin e kërkuar;

(iii) në çdo rast, diskriminimi për shkak të ndërgjegjes dhe fesë nuk mund të cenojë thelbin e të drejtave dhe lirive themelore dhe nuk mund të tejkalojë kufizimet e vendosura nga KEDNJ.

Nga vetë mënyra se si është formuluar, kjo dispozitë tregon se diskriminimi për shkak të ndërgjegjes dhe fesë nuk mund të interpretohet në mënyrë të gjerë por vetëm ngushtësisht. Një rast i lejimit të diskriminimit mbi këtë bazë mund të jetë p.sh., ndalimi i veshjeve fetare në shkollat ose institucionet publike laike. Gjithsesi zbatimi i kësaj dispozite në jurisprudencën shqiptare mbetet për t'u parë në praktikë.

#### 4.2.3 Diferencim për shkak të moshës

Neni 20 § 7 i ligjit Për Mbrojtjen nga Diskriminimi parashikon se:

*“Ndalimi i diskriminimit nuk zbatohet për caktimin e një moshe të veçantë për mundësi të përfitimeve sociale, të të mirave, lehtësive dhe shërbimeve, nëse ekzistojnë kriteret e arsyeshme e objektive për caktimin, pa cenuar thelbin e së drejtës për përfitime dhe kur caktimi synon të arrijë një qëllim të ligjshëm për një interes publik, ose për të mbrojtur të drejtat e të tjerëve, gjithmonë në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar caktimin”.*

Edhe në rastin e lejimit të këtij trajtimi të ndryshëm zbatohen kufizimet e përgjithshme si nevoja e ekzistencës së një justifikimi të arsyeshëm, objektiv që nuk cenon thelbin e së drejtës së përfitimeve dhe që synon të arrijë një qëllim legjitim siç është interesi publik apo mbrojtja e të drejtave të të tjerëve, gjithmonë duke ruajtur parimin e proporcionalitetit. Veçantia e këtij diferencimi është se ky lloj trajtimi që mban për bazë moshën, lejohet kryesisht për përfitime sociale, si p.sh., pensionet e pleqërisë, apo të mira dhe shërbime të tjera që lidhen me plotësimin e një moshe të caktuar p.sh., check-up pa pagesë i ofruar për një kategori të caktuar moshe.

## 5. OBJEKTI I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR KUNDËR DISKRIMINIMIT

Legjislacioni shqiptar kundër diskriminimit ofron mbrojtje në çdo aspekt dhe të drejtë të garantuar nga Kushtetuta e Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara dhe legjislacioni shqiptar në fuqi. Ky seksion do të trajtojë fushën e zbatimit dhe objektin e legjislacionit shqiptar kundër diskriminimit duke u përqendruar tek dy ligjet kryesore Kushtetuta dhe ligji Për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Ndërkohë, mbrojtja nga diskriminimi që ofrohet nga kodet dhe legjislacioni tjetër plotësues, e cila është e orientuar në sektor të veçantë sipas fushës që këto ligje rregullojnë, mbulohet edhe nga Kushtetuta dhe ligji Për Mbrojtjen nga diskriminimi, prandaj ato nuk do të trajtohen veçmas. Fillimisht do të paraqitet mbrojtja nga diskriminimi që ofron neni 18 i Kushtetutës së Shqipërisë dhe më pas do të trajtohen fushat e veçanta që janë objekt i ligjit Për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

### 5.1 Subjektet e mbrojtur

Kushtetuta shqiptare ofron mbrojtje të njëjtë nga diskriminimi si për shtetasit shqiptarë, të huaj, personat pa shtetësi dhe madje edhe personat juridikë<sup>67</sup>. Kushtetuta i kushton rëndësi të veçantë edhe mbrojtjes së pakicave kombëtare<sup>68</sup>. Subjektet që përfitojnë nga të drejtat që ofron Ligji shqiptar kundër diskriminimit janë të gjithë personat, që jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e Shqipërisë. Po ashtu të gjithë shtetasit shqiptarë, me banim të përkohshëm ose të përhershëm jashtë kufijve të Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ligji Për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare. Kurse personat e huaj me banim, vendqëndrim apo seli jashtë territorit të Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ligji Për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare<sup>69</sup>.

### 5.2 Mbrojtja sipas Kushtetutës

Kushtetuta shqiptare nëpërmjet sanksionimit se *“Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit”* dhe se *“Askush nuk mund të diskriminohet...”*, ofron një mbrojtje gjithëpërfshirëse nga diskriminimi jo vetëm në lidhje me të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në të, por në lidhje me çfarëdo lloj të drejte tjetër të parashikuar nga legjislacioni shqiptar

<sup>67</sup> Refero nenin 16 të Kushtetutës së RSH.

<sup>68</sup> Refero nenin 20 të Kushtetutës së RSH.

<sup>69</sup> Refero nenin 4 të Ligjit Nr.10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

në fuqi, që i përket qoftë aspektit të të drejtave civile dhe politike, qoftë atyre ekonomike e sociale. Mbrojtja ofrohet jo vetëm ndaj veprimeve dhe mosveprimeve të autoriteteve shtetërore por edhe ndaj atyre të subjekteve private, siç mund të jenë p.sh., në fushën e punësimit, të marrjes së të mirave dhe shërbimeve publike të ofruara nga subjektet private, siç është p.sh., aksesit në restorante e lokale, kujdesi shëndetësor privat, etj.

Përveç mbrojtjes nga diskriminimi në fusha të veçanta të tilla si punësimi, arsimit dhe të mirat dhe shërbimet që do të trajtohen më poshtë, Kushtetuta ofron edhe mbrojtje në fusha të tjera, të pambuluara nga ligji Për Mbrojtjen nga Diskriminimi siç janë mbrojtja në sferën e të drejtave vetjake e private, në sferën e të drejtave politike, dhe ato ekonomike, sociale, kulturore. Në fushën e të drejtave vetjake përfshihet mbrojtja nga diskriminimi në të drejta të tilla, si p.sh., mbrojtja e jetës parashikuar nga neni 21, mbrojtja e lirisë së shprehjes e mëshiruar në nenin 22, e lirisë së informimit e mëshiruar në nenin 23, e lirisë së ndërgjegjes dhe fesë e pasqyruar në nenin 24, mbrojtja nga trajtimi çnjerëzor dhe denigrues të parashikuara nga neni 25 i Kushtetutës, mbrojtja në fushën penale siç është p.sh., mbrojtja nga puna e detyruar, nga heqjet e lirisë, aksesit në drejtësi dhe një proces të rregullt ligjor, etj., të parashikuara në nenet 26-34 dhe 42 § 2 të Kushtetutës, etj. Një fushë e veçantë që Kushtetuta i ofron mbrojtje nga diskriminimi tej mbrojtjes që ofron legjislacioni i posaçëm kundër diskriminimit, është ajo që lidhet me të drejtat politike, siç janë p.sh., të drejtat për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur, e drejta për t'u organizuar në parti politike ose çdo lloj organizimi tjetër, e drejta për tubime, të parashikuara nga nenet 9, 45-48 të Kushtetutës. Por Kushtetuta shqiptare ofron një mbrojtje të veçantë nga diskriminimi edhe në sferën e të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore siç janë p.sh., në fushën familjare të mëshiruara në nenin 53 dhe 54 për mbrojtjen e martesës, familjes dhe fëmijëve e trajtimin e barabartë të tyre, apo edhe në sferën e krijimit artistik dhe shkencor të parashikuar në nenin 58. Në çdo rast, evidentimi i diskriminimit të ndodhur për një nga liritë dhe të drejtat në sektorët që përmenden në këtë paragraf, kryhet duke vlerësuar nëse shkëlja ka qenë e lidhur apo jo edhe me ndonjë prej karakteristikave të mbrojtura nga ligji. P.sh., dhunimi që policia mund ti bëjë një të ndaluar apo arrestuari që i përket komunitetit rom shihet nëse ka ndodhur apo jo edhe për shkak të përkatësisë etnike të këtij personi. Këtu përfshihet edhe marrja në shqyrtim nga institucionet publike jo vetëm të faktit nëse dhuna ka ndodhur, por edhe nëse viktimat është dhunuar apo i janë shkelur të drejtat vetjake, apo të aksesit në gjykatë, etj., për shkak të etnisë së tij, racës apo

çdo karakteristike tjetër të mbrojtur nga ligji<sup>70</sup>; ose trajtimi i diferencuar i të drejtave të prindërimit apo i takimit dhe marrëdhëniet me fëmijët në rastet e zgjidhjes së martesës, apo çështje të tilla si birësimi vlerësohet nëse ka ndodhur edhe për shkak të gjinisë, gjithmonë duke mbajtur parasysh përjashtimet e lejuara nga Kushtetuta për mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës<sup>71</sup>; trajtimi i diferencuar i fëmijëve shihet i lidhur me faktin nëse një diferencim i tillë ka ndodhur për shkak të gjendjes sociale të fëmijës p.sh., fëmijë i lindur nga martesa apo jashtë martese; refuzimi i lejes për tubim me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit kundër ksenofobisë ose orientimit seksual shihet i lidhur nëse ka ndodhur apo jo për një shkak të tillë si ksenofobia apo homofobia, etj.

### 5.3 Mbrojtja në fusha të veçanta

Ligji shqiptar Për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka për objekt zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mbrojtjen e saj në tre sfera kryesore, atë të punësimit, arsimimit dhe të mirave e shërbimeve. Shtrirja e saj në këto sfera është rrjedhojë e huazimeve dhe harmonizimeve të këtij ligji me direktivat evropiane kundër diskriminimit, të cilat e shtrijnë mbrojtjen nga diskriminimi kryesisht në këto tre fusha. Këto tre fusha gjejnë mbrojtje edhe nga Kushtetuta e Shqipërisë respektivisht në nenet 49-51 për çështjet e punësimit, nenin 57 për mbrojtjen e ofruar në arsim dhe nenet 52-56 në fushën e të mirave dhe shërbimeve.

#### 5.3.1 Mbrojtja në punësim

Kushtetuta e Shqipërisë jep një kuptim mjaft të gjerë të marrëdhënieve të punësimit duke përfshirë në të mjetet e jetesës, zgjedhjen e lirë të profesionit, vendit të punës, sistemin e kualifikimit, të drejtën për organizim në sindikata dhe për grevë, dhe çdo veprimtari ekonomike<sup>72</sup>. Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e punësimit shtrihet për të gjitha karakteristikat e mbrojtura nga Kushtetuta.

Kuptimi i së drejtës për punësim ka gjetur një pasqyrim të plotë

<sup>70</sup> Në këtë aspekt mbahet parasysh edhe praktika e vendosur nga GJEDNJ duke qenë se Kushtetuta e RSH e ka ngritur nivelin minimal të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në të njëjtin nivel me atë të vendosur nga KEDNJ. Për më shumë refero Fundamental Rights Agency and Council of Europe. (2010). Handbook on European non-discrimination law, Luxembourg: Publications Office of the European Union, fq. 82.

<sup>71</sup> Për më shumë refero Fundamental Rights Agency and Council of Europe. (2010). Handbook on European non-discrimination law, Luxembourg: Publications Office of the European Union, fq. 79.

<sup>72</sup> Refero nenin 11, 49-51 të Kushtetutës së RSH.

edhe në ligjin Për Mbrojtjen nga Diskriminimi sipas të cilit në këtë të drejtë përfshihet<sup>73</sup>:

- (i) shpallja e vendeve të lira të punës. Këtu përfshihen jo vetëm kushtet përpara punësimit por edhe të gjithë ato faktorë që ndikojnë në vendimmarrjen e individit për të pranuar apo jo një pozicion të caktuar, siç mund të jetë p.sh., përfitimi i një pagese të caktuar<sup>74</sup>;
- (ii) rekrutimi dhe përzgjedhja e punëmarrësve;
- (iii) trajtimi i punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës. Në lidhje me kushtet e punës, jurisprudenca e huaj ka bërë një trajtim të gjerë duke përfshirë si pjesë e kushteve të punës çdo lloj kushti që rrjedh nga ekzistenca ose për shkak të marrëdhënies së punës, edhe pse kushti në vetvete mund të jetë i një natyre sociale si p.sh., ndihma sociale që mund t'i jepet prindit me fëmijë të mitur, që është në marrëdhënie pune por që ka të ardhura të ulta, etj<sup>75</sup>. Në lidhje me shpërblimet kuptohet jo vetëm paga por edhe çfarëdo lloj shpërblimi që rrjedh nga puna si p.sh., paga e fund vitit, apo dietat, shpenzimet e udhëtimit, etj. Në lidhje me zgjidhjen e kontratës kuptohet çfarëdo lloj zgjidhje përfshirë zgjidhjet për shkak rristrukturimi, për shkak të daljes së detyrueshme në pensioni, etj;
- (iv) anëtarësimi në sindikata dhe mundësia për të përfituar nga lehtësitë që siguron kjo anëtarësi.

Kuptimi i së drejtës për punë parashikohet pak a shumë në të njëjtën mënyrë edhe nga Kodi i Punës<sup>76</sup>. Parashikimet që ofron ligji Për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Kodi i Punës në lidhje me ndalimin e diskriminimit

<sup>73</sup> Refero nenin 12 të Ligjit Nr.10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi".

<sup>74</sup> Fundamental Rights Agency and Council of Europe. (2010). Handbook on European non-discrimination law, Luxembourg: Publications Office of the European Union, fq. 65.

<sup>75</sup> Fundamental Rights Agency and Council of Europe. (2010). Handbook on European non-discrimination law, Luxembourg: Publications Office of the European Union, fq. 66.

<sup>76</sup> Neni 9/5 i Kodit të Punës parashikon se:

- "Në kuptim të këtij neni, ndalimi i diskriminimit dhe zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion zbatohet në lidhje me:
- a) mundësinë për punësim, vetëpunësim dhe profesion, duke përfshirë kriteret e përzgjedhjes dhe kushtet e rekrutimit, të çfarëdo lloj dege të aktivitetit dhe në të gjitha nivelet e hierarkisë profesionale, si dhe ngritjen në detyrë;
  - b) qasjen në të gjitha llojet dhe në të gjitha nivelet e orientimit profesional, trajnimet profesionale, trajnimet dhe ri trajnimet të avancuar profesional, përfshirë edhe përvojën e punës në praktikë;
  - c) kushtet e punës dhe punësimit, përfshirë zgjidhjen e kontratës së punës dhe pagën;
  - d) anëtarësimin dhe aktivizimin në organizata sindikale dhe organizata të punëdhënësve, ose ndonjë organizatë, anëtarët e së cilës ushtrojnë një profesion të caktuar, duke përfshirë përfitimet e siguruar nga këto organizata".



në të drejtën për punësim janë të harmonizuara me direktivat e BE dhe praktikën e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (GJED) në këtë drejtim.

Ligji shqiptar i ofron punëmarrësve mjete juridike për t'u mbrojtur nga diskriminimi në të drejtat për punësim nëpërmjet ankimit tek punëdhënësi, KMD ose gjykatë, si dhe në çdo institucion tjetër të ngritur pranë sektorëve të punësimit. Kur punëmarrësi ankohet tek punëdhënësi ky i fundit detyrohet ta shqyrtojë ankesën brenda një muaji. Gjatë periudhës së shqyrtimit të ankesës punëmarrësi ka të drejtë të vazhdojë punën sipas kushteve të tij të kontratës dhe, në rast të mos marrjes së masave për të hetuar nga ana e punëdhënësit në lidhje me ankimin e punëmarrësit, ky i fundit ka të drejtë të ndërpresë punën pa humbur të drejtën e pagës, deri në momentin që është e nevojshme për t'u mbrojtur nga diskriminimi<sup>77</sup>.

### 5.3.2 Mbrojtja në arsim

Kushtetuta e Shqipërisë ofron mbrojtje të veçantë në fushën e arsimit nëpërmjet nenit 57 të saj. Në këtë të drejtë përfshihet arsimi shkollor i detyrueshëm, arsimi i mesëm i përgjithshëm publik, i cili është i hapur për të gjithë, arsimi i mesëm profesional i cili mund t'i nënshtrohet kufizimeve të veçanta që lidhen me kritere aftësie, arsimi jopublik, autonomia institucionale e arsimit të lartë dhe liria akademike.

Ndërkohë, ligji Për Mbrojtjen nga Diskriminimi është kufizuar vetëm në mbrojtjen e të drejtës për arsim në institucionet publike. Sipas nenit 17 § 1 të ligjit ndalohet çfarëdo lloj diskriminimi në arsimin publik që ka lidhje me:

- (i) krijimin e institucioneve publike ose private që ofrojnë shërbime arsimore ose profesionale;
- (ii) financimin e institucioneve publike që ofrojnë shërbime arsimore ose profesionale;
- (iii) përmbajtjen e parimeve dhe kritereve të veprimtarisë arsimore, duke përfshirë programet mësimore dhe metodat e mësimdhënies;
- (iv) trajtimin e studentëve ose nxënësve, duke përfshirë pranimin, vlerësimin, zbatimin e masave disiplinore ose përjashtimin e tyre.

Veç sa më lart, ligji ndalon gjithashtu në mënyrë të shprehur që t'i refuzohet një personi ose një grupi personash pranimi në një institucion arsimor publik, për një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji.

<sup>77</sup> Nenet 13, 15 të Ligjit Nr.10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi".

Në çdo rast të një ankese për diskriminim, institucioni arsimor duhet të marrë masat e nevojshme me qëllim shqyrtimin e ankesës dhe, nëse është rasti, marrjen e masave të nevojshme për ndalimin e diskriminimit brenda 30 ditëve nga paraqitja e saj.

Vihet re se kjo mbrojtje ofrohet në të drejtën për arsimin publik kurse mbrojtja nga diskriminimi në të drejtën për arsim në sektorin privat, prezumohet se mbulohet nga mbrojtja që ligji ofron në fushën e të mirave dhe shërbimeve që trajtohet më poshtë.

### 5.3.3 Mbrojtja në fushën e të mirave dhe shërbimeve

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve nënkupton ndalimin e diskriminimit nga cilido person fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, kundrejt një personi tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato, qoftë duke (i) i refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji, qoftë duke i refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi<sup>78</sup>.

Gama e të mirave dhe shërbimeve që përfshihen në fushën e mbrojtur nga diskriminimi nga legjislacioni shqiptar është e gjerë. Në Kushtetutë mbrojtja nga diskriminimi në këtë fushë mëshirohet më tepër në liritë dhe të drejtat e karakterit social-ekonomik nëpërmjet të cilave kërkohet që të arrihet barazia në trajtim dhe ndalimi i diskriminimit. Konkretisht në Kushtetutë mbrojtjen nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve e gjejmë më tepër të shprehur në:

- (i) nenin 37 për paprekshmërinë e banesës dhe të mjediseve që njehsohen me të e cila garanton barazinë e individëve në strehim;
- (ii) nenin 38 për përzgjedhjen e vendbanimit që lidhet me nenin 37;
- (iii) nenin 11, 41 e 42 § 1 për mbrojtjen e pronës private që garantojnë barazinë në trajtim në çdo aspekt që lidhet me pronën si shitjen, dhënien me qira, trashëgiminë, shpronësimet, etj;
- (iv) nenin 33 § 1 dhe 42 § 2 për të drejtën e një procesi të rregullt ligjor, që konsiston në barazinë e aksesit në gjykatë dhe procedurave ligjore para gjykatës;

<sup>78</sup> Refero nenin 20 § 1 të Ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi".

- (v) nenin 11, 49 për lirinë e përzgjedhjes së profesionit dhe mbrojtjen shoqërore të punës;
- (vi) nenin 52 dhe 55 § 2 në lidhje me të drejtën për përfitim nga e drejta për sigurime shoqërore, pension dhe ndihmës ekonomike;
- (vii) nenin 55 për të drejtën e përfitimit të kujdesit shëndetësor nga shteti dhe të sigurimit shëndetësor.

Ndërkohë ligji Për Mbrojtjen nga Diskriminimi ofron një panoramë akoma më të detajuar të fushës të së mirave dhe shërbimeve që gjejnë mbrojtje, duke përfshirë jo vetëm ato që ofrohen kundrejt publikut me pagesë por edhe ato pa pagesë, duke tejkaluar madje edhe parashikimet e legjislacioni të BE në këtë drejtim<sup>79</sup>. Ligji shqiptar Për Mbrojtjen nga Diskriminimi parashikon në nenin 20 § 2 se në veçanti në fushën e të mirave dhe shërbimeve përfshihen:

- (i) mundësia për të hyrë në një vend ku publiku lejohet të hyjë ose për të përdorur një vend, i cili lejohet për t'u përdorur nga publiku. Këtu mund të përfshihen restorantet, baret, dyqanet, etj;
- (ii) mundësi për të marrë ose për të përfituar nga të mirat apo shërbimet që kanë të bëjnë me shëndetin. Këtu përfshihet aksesin në shëndetësi, që nënkupton aksesin në shërbimin administrativ dhe mjekësor. Por, në të njëjtën kohë, në të mirat dhe shërbimet e lidhura me shëndetin përfshihen edhe ato shëndetësore, që përfshijnë sigurimet e detyrueshme shëndetësore të institucioneve publike dhe ato të ofruara nga institucionet private. Në këtë sektor përfshihen edhe shërbimet shëndetësore private kur pacientët rimbursohen nëpërmjet skemës së detyrueshme të sigurimit, si p.sh., rimbursimi i barnave të listës, i shërbimeve të hemodializës, i shërbimeve check-up, etj. Në një rast të tillë, refuzimi për sigurim ose rimbursim, ose rritja e primit të sigurimit bazuar në një nga karakteristikat e mbrojtura të ligjit si p.sh., raca, etnia, etj., është objekt i të mirave dhe shërbimeve<sup>80</sup>;
- (iii) kontributin dhe mundësinë për të përfituar të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh

<sup>79</sup> Për më shumë refero Fundamental Rights Agency and Council of Europe. (2010). Handbook on European non-discrimination law, Luxembourg: Publications Office of the European Union, fq. 73, 74.

<sup>80</sup> Për më shumë refero Fundamental Rights Agency and Council of Europe. (2010). Handbook on European non-discrimination law, Luxembourg: Publications Office of the European Union, fq. 70, 74.

tjetër social të ofruar për publikun. Pika 6 e nenit 20 të ligjit parashikon se: *“kostot lidhur me shtatzëninë dhe amësinë nuk mund të përbëjnë shkak për dallime në shpërblimet dhe përfitimet e individit”*;

- (iv) mundësi për të përdorur ose për të hyrë në një institucion arsimor;
- (v) sistemimin në një vend ku ofrohet strehim. Kushtetuta jonë konsideron vendbanim apo strehim edhe çdo mjedis që njehsohet me të<sup>81</sup>. Kjo qasje nuk ndryshon nga interpretimet e dhëna nga GJEDNJ në lidhje me këtë drejtim, e cila në praktikën e saj ka vlerësuar se si strehim konsiderohen edhe vendbanimet e lëvizshme si karvanet, rulotat, etj., madje edhe në rastin kur ato janë vendosur në një vend në mënyrë të paligjshme<sup>82</sup>. Kuptimi mbi strehimin e përshtatshëm merr rëndësi në veçanti në rastin e komuniteteve vunerabël të cilët historikisht kanë qenë objekt diskriminimi si p.sh., komuniteti rom. Në këto raste, dhënia e mundësive të barabarta për strehim kërkon patjetër që strehimi të plotësojë edhe disa kushte minimale si p.sh., siguria nga faktorë të jashtëm, ndërhyrje të dhunshme, qëndrueshmëria e vendbanimit, infrastruktura e nevojshme si p.sh., lidhja me shërbimet utilitare si energji elektrike dhe ujë, me shërbimet publike, vendndodhje e tyre në një pozicion që lejon dhe nuk pengon mundësitë për punësim, që janë të përbalueshme, etj<sup>83</sup>;
- (vi) shitjen ose dhënien me qira të banesave dhe të mjediseve të tjera. Shitja ose dhënia me qira e banesave dhe e mjediseve të tjera shihet e lidhur edhe me strehimin veçanërisht kur bëhet fjalë për ofrimin e kësaj kategorie shërbimesh tek individ që i përkasin një komuniteti të veçantë, p.sh., rom ose të etnive të tjera. Në këtë drejtim i kushtohet rëndësi jo vetëm faktit të trajtimit të barabartë të individëve nga subjektet publike dhe private në ofrimin e këtyre shërbimeve, por në mënyrën se si bëhet shpërndarja apo mirëmbajtja e ambienteve të shitura apo të dhëna me qira. P.sh., vlerësohet diskriminues shitja apo dhënia me qira e ambienteve të një cilësie të ulët tek një komunitet i caktuar, dhënia me çmim shitje apo qira më të lartë i ambienteve, mosmirëmbajtja e ambienteve që banohen nga një kategori e caktuar personash, etj<sup>84</sup>;
- (vii) shërbimet e bankës dhe mundësi për të siguruar grante, huadhënie, depozita bankare ose financim;

<sup>81</sup> Refero nenin 37 § 2 të Kushtetutës së RSH.

<sup>82</sup> Për më shumë refero Fundamental Rights Agency and Council of Europe. (2010). Handbook on European non-discrimination law, Luxembourg: Publications Office of the European Union, fq. 74, 75.

<sup>83</sup> Po aty.

<sup>84</sup> Po aty.

- (viii) lehtësi për argëtim, çlodhje e freskim;
- (ix) lehtësi për transport ose udhëtim, p.sh., tarifa më të ulta udhëtimi, karta studenti, etj;
- (x) shërbimet e profesioneve të lira.

Pavarësisht se në parim ndalimi i diskriminimit në fushën e të mirave dhe shërbimeve zbatohet për cilëndo nga karakteristikat e mbrojtura nga ligji si p.sh., raca, gjinia, etnia, etj., ligji përcakton se ndalimi i diskriminimit nuk zbatohet për caktimin e një moshe të veçantë për mundësi të përfitimeve sociale, p.sh., pensioneve, të të mirave, lehtësive dhe shërbimeve p.sh., check-up pa pagesë i ofruar për një kategori të caktuar moshe, nëse ekzistojnë kritere të arsyeshme e objektive për caktimin, pa cenuar thelbin e së drejtës për përfitime dhe kur caktimi synon të arrijë një qëllim të ligjshëm për një interes publik, ose për të mbrojtur të drejtat e të tjerëve, gjithmonë në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar caktimin. Po ashtu nuk përbëjnë diskriminim as dallimet në shpërblime dhe përfitime, të vendosura për një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji, kur këto dallime janë të arsyeshme dhe në përpjesëtim me një rrezik, i cili vlerësohet në bazë të të dhënave aktuale dhe statistikore të vërtetueshme dhe të lidhura ngushtë me rrezikun. Gjithsesi, kostot lidhur me shtatzëninë dhe amësinë nuk mund të rezultojnë shkak për dallime në shpërblimet dhe përfitimet e individit<sup>85</sup>.

## 6. BARRA E PROVËS

Rrallë ndodh që diskriminimi dhe shkakun që e ka nxitur atë të manifestohen në mënyrë të hapur, madje edhe në ato raste kur diskriminimi është i drejtpërdrejtë. Kjo ndodh sepse motivi i diskriminimit lidhet kryesisht me element paragjyqës të ushtruesit të diskriminimit dhe ky motiv qëndron në mendjen e tij pa u bërë publik. Vështirësia për të evidentuar se diskriminimi ka ndodhur për një shkak të mbrojtur ka bërë që legjislativi të lejojë ndarjen e barrës së provës ndërmjet viktimës dhe personit që ka diskriminuar. Në këtë rast, mjafton që viktimi të tregojë fakte të mjaftueshme nga të cilat prezumohet se diskriminimi ka ndodhur për shkakun e pretenduar dhe më pas barra për të provuar të kundërtën i kalon personit që ka ushtruar diskriminimin. Në këtë rast gjykata duhet të bindet se i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e ndryshëm ka qenë pikërisht karakteristika e

<sup>85</sup> Neni 20 § 5, 6, 7 i Ligjit Nr.10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi".

mbrojtur nga ligji<sup>86</sup>. Ndarja e barrës së provës vjen mjaft në ndihmë në veçanti në rastet e diskriminimit të tërthortë, provimi i të cilës kërkon mbështetjen mbi të dhëna statistikore me anë të të cilave mund të tregohet se si rregulla të caktuara, të cilat në dukje janë neutrale, kanë ndikuar në mënyrë të pafavorshme e të shpërpjesëtuar tek grupe të veçanta.

Ndarja e barrës së provës në rastin e diskriminimit gjen mbështetje edhe në legjislativin tonë, p.sh., në nenin 36 § 6 të ligjit Për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>87</sup> dhe nenin 9 § 10 të Kodit të Punës<sup>88</sup>, duke bërë një anashkalim dhe risi nga parimi i përgjithshëm i sanksionuar në nenin 12 të Kodit të Procedurës Civile sipas të cilit barra e provës i përket palës që e pretendon një fakt. Ndarja e barrës së provës në rastin e diskriminimit është pranuar edhe nga GJEDNJ-ja e cila ka pranuar t'i shohë provat në tërësinë e tyre e duke mbajtur në konsideratë faktin se shtetet kanë më tepër kontroll mbi informacionin e nevojshëm për të provuar një pretendim. Prandaj nëse faktet e paraqitura nga viktimi janë të besueshme dhe në përputhje me provat e disponueshme, GJEDNJ-ja i ka konsideruar këto fakte si të provuara, me përjashtim kur shteti ka arritur të sjellë prova bindëse që tregojnë të kundërtën. Pala që pretendohet se ka ushtruar diskriminim mund të provojë të kundërtën duke treguar ose se viktimi nuk ndodhet në një situatë të krahasueshme me personat e tjerë; ose se trajtimi i diferencuar nuk është për një nga shkaqet e mbrojtura por për shkaqe të tjera objektive të lejuara si ato të treguara në seksionin 4; ose të argumentojë se trajtimi i ndryshëm ka qenë i përligjur objektivisht dhe proporcional<sup>89</sup>.

Në rastin e diskriminimit ajo që duhet provuar është trajtimi i ndryshëm dhe shkakun i mbrojtur mbi bazën e të cilit po ndodh diskriminimi. Rrethana të tjera si p.sh., motivet e diskriminimit, prirjet paragjyqëse, raciste etj., të ushtruesit të diskriminimit nuk kanë nevojë të provohen. Po ashtu, nuk ka nevojë që të provohet se një rregull apo praktikë e caktuar

<sup>86</sup> Fundamental Rights Agency and Council of Europe. (2010). Handbook on European non-discrimination law, Luxembourg: Publications Office of the European Union, fq. 124.

<sup>87</sup> Neni 36 § 6 i Ligjit Nr.10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi" parashikon se: "Pasi paditësi paraqet prova, mbi të cilat bazon pretendimin e tij dhe në bazë të të cilave gjykata mund të prezumojë sjelljen diskriminuese, i padituri detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim sipas këtij ligji".

<sup>88</sup> Neni 9 § 10 i K.Punës parashikon se: "Në të gjitha procedurat e ankimit, që ndiqen sipas pikës 9, të këtij neni, nëse ankuesi ose paditësi paraqet fakte nga të cilat mund të pretendohet se është diskriminuar në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, personi ndaj të cilit paraqitet ankesa ose i padituri detyrohet të provojë se nuk është shkelur parimi i trajtimit të barabartë".

<sup>89</sup> Fundamental Rights Agency and Council of Europe. (2010). Handbook on European non-discrimination law, Luxembourg: Publications Office of the European Union, fq. 126.

e ndjekur nga një institucion publik apo privat ka pasur për synim që të diskriminojë personat. Në këto raste mjafton që të tregohet se rezultati i zbatimit të rregullit apo praktikës ka çuar në trajtime të diferencuara e të pafavorshme të një grupi të caktuar, pavarësisht qëllimit që ka pasur vetë norma apo praktika e ndjekur<sup>90</sup>.

<sup>90</sup> Po aty fq. 127.

## RASTE TË SHQYRTUARA NGA KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

### RASTI NR. 1

**Faktet** – Kërkesja X.Y., ka përfituar nga një projekt i menaxhuar nga Bashkia Vlorë, e cila ka pasur si qëllim rikonstrukcionin e banesave të komitetit egjiptian në qytetin e Vlorës. Kërkesja pretendon se punimet e kryera nga firma ndërtuese janë të një cilësie tepër të dobët, lagështia është përhapur kudo në ambientet e shtëpisë dhe për më tepër punimet janë lënë të papërfunduara. Znj. X.Y., jeton me vëllain e saj A.Y., i cili është një person me aftësi të kufizuara dhe e ka të pamundur jetesën në kushte të tilla. Për këtë znj. X.Y., i është drejtuar zyra të Bashkisë Vlorë, por nuk ka marrë asnjë përgjigje nga ky institucion. Gjendur në këto kushte znj. X.Y., i është drejtuar Komisionerit për diskriminim për shkak të **racës dhe aftësisë së kufizuar**.

**Vendimi** – Pasi ka marrë në shqyrtim rastin në fjalë, Komisioneri ka kryer verifikime në banesën e kërkeses dhe ka evidentuar problematikat e parashtruara prej saj dhe në bazë të neneve 1, 2, 3 §1, 4 § 1, 7 § 1, 20, 21, 21 § 1, 32 § 1, 33 § 1, 3, 5, 7, 10 të ligjit 10221, dt. 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ka konstatuar diskriminim për shkak të racës (Egjiptiane) të znj. X.Y., dhe diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar të z. A.Y., nga ana e Bashkisë Vlorë dhe ka urdhëruar këtë bashki për marrjen e masave të menjëhershme për ngritjen e një grupi pune me ekspertë të fushës për të verifikuar nga ana teknike cilësinë e punimeve në banesën e familjes Y. Gjithashtu, ka kërkuar marrjen e masave të menjëhershme duke u mbështetur në përfundimet e grupit të punës, për riparimin dhe shtimin e punimeve në banesën e familjes Y.

### RASTI NR. 2

**Faktet** – OJF-ja X., dhe shoqata Y., kanë paraqitur pranë Komisionerit, ankesat e trajtuara nga ana e pacientëve për mungesë të ilaçeve që janë pjesë e kimioterapisë për mjekimin e sëmundjeve në

Shërbimin e Hematologjisë pranë QSUT-së. Sipas këtyre ankesave, për shkak të mungesës së ilaçeve, pacientët e planifikuar për mjekim pranë këtij pavijoni në janar 2017 kanë dalë nga spitali pa marrë mjekimin e planifikuar sipas terapisë mjekësore. Disa ilaçe që duhet të sigurohen nga shteti janë të papërbalueshme për shkak të kostos së lartë financiare, ndërsa ilaçe të tjera pacientët i sigurojnë me të ardhurat e tyre. Mungesat e ilaçeve të mësipërme rezultojnë në kartelat mjekësore të pacientëve që trajtohen në këtë pavijon, pasi mjekët përgjegjës për ndjekjen e terapisë si dhe zhvillimin e cikleve kanë bërë shënimet për mungesën e këtyre ilaçeve. OFJ-ja X., dhe shoqata Y., vlerësojnë se, praktika e mungesës së ilaçeve dhe mjekimit të mangët ndaj të gjithë pacientëve, dhe posaçërisht ndaj pacientes G.D., i ka venë pacientët e sëmurë me kancer në gjak në kushte jo të favorshme për shkak të **gjendjes së tyre shëndetësore** dhe **gjendjes së vështirë ekonomike**, në raport me personat e tjerë, si dhe cenon jetën e shëndetin e tyre”.

**Vendimi** – Pas marrjes në shqyrtim të kërkesës, Komisioneri ka bërë njoftim dhe kërkesë për informacion për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë (QSUT) në lidhje me ankesën për pretendimin për diskriminim në bazë të gjendjes shëndetësore dhe gjendjes së vështirë ekonomike si dhe i ka kërkuar QSUT, informacion në lidhje me barnat që janë trajtuar pacientët (në veçanti pacientja G.D.) gjatë muajit janar 2017, dhe si janë siguruar. Kopje të shkresave që janë dërguar në MSH lidhur me problematikat dhe mospjesëmarrjen e ilaçeve për pacientët e pavionit të Hematologjisë dhe përgjigjet e marra nga ministria. - Çfarë veprimesh të tjera ka bërë QSUT-ja për sigurimin e barnave në kohë? Pas kësaj, Komisioneri vendosi të realizojë një seancë dëgjimore mes palëve e cila nuk u realizua për mospjesëmarrjen e përfaqësuesve të QSUT-së. Sa më sipër, rezulton se QSUT-ja ka përgjegjësinë e sigurimit dhe miradministrit të barnave për pacientët. QSUT nuk i vendosi në dispozicion Komisionerit asnjë dokument që të provonte se Drejtoria e Shërbimit Farmaceutik, kishte bërë propozimet përkatëse për zgjidhjen në kohë të situatës së mungesës së barnave në Shërbimin e Hematologjisë. Pasi shqyrtoi rastin në fjalë Komisioneri konstatoi se ka pasur diskriminim të drejtpërdrejtë, të G.D., dhe të gjithë pacientëve të shërbimit të Hematologjisë, për shkak të gjendjes shëndetësore, nga ana e QSUT-së. Gjithashtu, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, si subjekt që ka konsumuar sjelljen diskriminuese, të sigurojë në kohë dhe në sasi, medikamentet mjekësore që nevojiten në Shërbimin e Hematologjisë, sipas parashikimeve ligjore.

### RASTI NR. 3

**Faktet** – D.Q., deklaroi se, në korrik 2017 është thirrur në zyrë nga nëndrejtori ekonomik, M.G., (eksponent i PS) dhe i është kërkuar dorëheqja me arsyen se ishte anëtar i LSI-së. Pas refuzimit të dorëheqjes, ai është ulur në detyrë nga pozicioni përgjegjës i IT në pozicionin operator në sektorin e IT. D.Q., ka kërkuar bazën ligjore dhe arsyet e uljes në detyrë, por nuk ka marrë përgjigje. Më pas ka dalë një urdhër tjetër që urdhëronte D.Q., që të kryente shërbimin e rojës, detyrë që e ka kryer për një muaj. Ai pretendon se i është bërë presion se do largohet nga puna sapo të vijë drejtori i ri. D.Q., i është drejtuar sërish Drejtorisë së Spitalit Rajonal Gjirokastër lidhur me kërkesën e tij për rishikim të urdhrit për uljen nga detyra, ku i bën me dije se ky është një veprim arbitrar dhe tendencioz nga ana e z/drejtorit administrativ. D.Q., ka kaluar përkohësisht në funksion të Sektorit Teknik, me arsyetimin se në Sektorin e IT-së nuk ka qenë eficient. D.Q., i ka kërkuar Përgjegjësit të Sektorit Teknik, ku ishte kaluar me Urdhrin e sipërcituar, që t'i përcaktohej qartë puna dhe detyrat që duhej të kryente në këtë sektor. Më dt 17.11.2017, D.Q. pretendon se i është komunikuar verbalisht pezullimi nga puna, me arsyetimin se nuk i ishte bindur Përgjegjësit të Sektorit Teknik. Lidhur me këtë situatë të krijuar, ankuesi i është drejtuar Spitalit Rajonal Gjirokastër, duke kërkuar t'i jepej fund sjelljes diskriminuese dhe të padrejtë ndaj tij. Drejtori i Spitalit Rajonal Gjirokastër ka urdhëruar lirim të menjëhershëm nga detyra të D.Q. Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrotjtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit.

**Vendimi** – Pas marrjes në shqyrtim të kërkesës, duke konstatuar disa mangësi në dokumentacion dhe informacion, Komisioneri i ka kërkuar D.Q., plotësimin e tyre. Gjithashtu, i ka nisur kërkesë Spitalit Rajonal Gjirokastër lidhur me pretendimet e D.Q., i cili nuk ktheu përgjigje. Nga një rikujtesë e dytë nga ana e Komisionerit, Spitali Rajonal ka kthyer përgjigje, por jo për të gjitha kërkesat dhe pa dokumentacion shoqëruar provues. Nga ana e Komisionerit janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepte shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues. Në këto rrethana, Komisioneri mbështetet kryesisht në dokumentacionin e sjellë nga pala ankuese, duke konstatuar **diskriminimin për shkak të bindjeve politike** të D.Q., nga ana e Spitalit Rajonal Gjirokastër.

#### RASTI NR. 4

**Faktet** – Znj. K.N., ka lindur në Vlorë, është e diplomuar për “Mësuesi”, dega “Cikël i Ulët” dhe është duke ndjekur studimet pasuniversitare për Master Profesional, dega “Psikologji Klinike”, pranë IAL jo-publike. Ajo ka punuar prej 2011, pranë I.E.V.P., Vlorë, duke mbajtur pozicione të ndryshme pune. Në 2016, ankuesja është emëruar “specialiste edukimi”, detyrë të cilën e ka ushtruar deri në 2018, moment në të cilin, nëpërmjet Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, ajo është liruar nga detyra, me motivacion “mospërputhje e kriterëve arsimore me funksionin organik”. Ankuesja pretendon se është liruar padrejtësisht nga detyra dhe është diskriminuar për shkak të moshës dhe gjinisë, nga ana e Drejtorit të I.E.V.P., Vlorë.

**Vendimi** – Mbështetur në provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, rezulton se ankuesja pavarësisht se ka qenë në kushte të njëjta me punonjës të tjerë të I.E.V.P. Vlorë, është trajtuar ndryshe. Gjatë analizimit të provave rezultoi se 4 (katër) punonjës të tjerë të gjinisë mashkullore, përkatësisht Z. E. M., Z. F. F., Z. D. E. dhe K. D., pavarësisht se nuk plotësonin kriterin arsimor për pozicionin e tyre të punës, janë mbajtur në punë dhe nuk janë liruar nga detyra, sikurse është vepruar për znj. K.N. Nisur nga fakti se punonjësit e trajtuar në mënyrë të favorshme i përkasin gjinisë mashkullore dhe e vetmja punonjëse, e cila është trajtuar ndryshe në të njëjtat kushte e rrethana, i përket gjinisë femërore, bën që Komisioneri të gjykojë se Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe I.E.V.P. Vlorë e kanë diskriminuar znj. K.N. për shkak të gjinisë. Sipas nenit 7 § 1, nenit 12 § 1, gërma c, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, si dhe nenit 69, të ligjit nr. 9970, datë 24.07.2008, “Për barazinë gjinore në Shqipëri”, Komisioneri gjykon se znj. K.N. i është nënshtruar një trajtimi diskriminues për shkak të gjinisë.

#### RASTI NR. 5

**Faktet** – E.G.J., ka filluar punë në pozicionin e përfaqësuesit në terren, të Kompanisë Philip Morris Albania (PMA), në 2014. Sipas tij, gjatë detyrës së ushtruar, ka punuar me përkushtim duke u vlerësuar pozitivisht nga eprorët. Në 2017, është bërë prind i fëmijës së dytë të tij. Në këto kushte, referuar legjislacionit në fuqi, i cili parashikon se 63 ditë pas lindjes së fëmijës babai mund të kërkojë lejen e lindjes, në fund të tetorit 2017, ankuesi ka kërkuar nga ana e punëdhënësit të përfitojë këtë të drejtë për

t’u kujdesur për fëmijën e tij. Mbështetur në kërkesat e vazhdueshme verbale, punëdhënësi e ka njoftuar se mund të fillojë lejen e lindjes së fëmijës, në janar 2018, si dhe për këtë kompania mund t’i miratojë vetëm për një afat prej 4 (katër) muajsh. Momenti i dytë ku ankuesi është ndjerë i trajtuar në mënyrë diskriminuese, lidhet me faktin se një punonjëse femër e kompanisë, në nëntor 2017, ka përfituar lejen e plotë të lindjes prej 12 muajsh, ndërsa kërkesa e tij nuk është miratuar nga punëdhënësi. Gjithashtu, ndryshe nga punonjëset femra, pasi ka nisur lejen e lindjes në janar 2018, i është bllokuar aksesi në sistemet e brendshme të kompanisë dhe i është kërkuar të dorëzojë të gjithë asetet e punës. Pasi ka vënë në dijeni punëdhënësin lidhur me kthimin në vendin e punës, më 2018, ka marrë njoftimin për zgjidhje të menjëhershme të marrëdhënieve të punës për shkak të shkeljeve të rënda të kontratës së punës. Sipas ankuesit, largimi i tij nga puna nuk lidhet me shkeljen e pretenduar nga punëdhënësi, por me kërkesën e tij për përfitimin e lejes së lindjes. Në përfundim, ankuesi kërkon nga Komisioneri, konstatimin e trajtimit të pabarabartë dhe diskriminues për shkak të gjinisë, përkatësisë prindërore dhe gjendjes familjare, nga ana e Shoqërisë Philip Morris Albania sh.p.k..

**Vendimi** – Me qëllim marrjen e një vendimi sa më objektiv, Komisioneri ftoi palët në seancë dëgjimore. Në analizë të fakteve dhe provave të marra në shqyrtim rezultoi se PMA, në ndryshim nga punonjëset femra të kompanisë që kanë përfituar leje të plotë lindje, ankuesit nuk i është dhënë mundësia për të përfituar lejen e plotë dhe nuk i është dhënë mundësia për të përdorur asetet e kompanisë edhe gjatë lejes. Në këto kushte, evidentohet se në raport me punonjëset femra të PMA-së, ankuesi është trajtuar në mënyrë të pafavorshme dhe të pabarabartë. Komisioneri vlerësoi se nga ana e punëdhënësit, nuk u sollën argumente ose prova për të hedhur poshtë pretendimin e ankuesit se miratimi i lejes për kujdes ndaj fëmijës, për një periudhë më të shkurtër në raport me punonjëset femra të PMA-së, ka ardhur si pasojë e gjinisë, së ankuesit. Për rrjedhojë, u konstatua diskriminimi i shtetasit E.G.J., nga ana e Shoqërisë Philip Morris Albania sh.p.k., për **shkak të gjinisë**.

## II. NDALIMI DHE MBROJTJA NGA DISKRIMINIMI NË TË DREJTËN NDËRKOMBËTARE

Në referim të kuptimit klasik drejta ndërkombëtare rregullon marrëdhëniet mes shteteve dhe bazohet në parimin e reciprocitetit<sup>91</sup>. Rrjedha historike e Luftës së Dytë Botërore e bëri domosdoshmëri mbrojtjen e qytetarëve nga vetë shteti juridiksionit të cilit i përkisnin. Ndërkohë, që përpara Luftës nuk mund të imagjinohej se e drejta ndërkombëtare mund të rregullonte marrëdhëniet e shtetit me vetë qytetarët e tij. Pikërisht, instrumentet ligjore që garantojnë të Drejtat e Njeriut sfidojnë parimin e reciprocitetit<sup>92</sup>. Nuk ka dyshim që qëllimi kryesor i kësaj mbrojtjeje kombëtare dhe ndërkombëtare është parandalimi i shkeljes së këtyre të drejtave<sup>93</sup>.

Në nivel ndërkombëtar reagimi i parë juridiko-ndërkombëtar pas dy luftërave botërore, që krijoi bazën juridike për mbrojtjen nga diskriminimi është akti themelor i Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), **Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut** (1948)<sup>94</sup>, e cila konsiderohet si guri i themelit për garantimin e të drejtave të njeriut. Neni 2 i saj sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi:

*Secili gëzon të gjitha të drejtat dhe liritë e parashtruara në këtë Deklaratë pa kurrfarë kufizimesh për sa i përket racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, besimit fetar, mendimit politik ose tjetër, origjinës kombëtare a shoqërore, pasurisë, lindjes ose tjetër.*

*Asnjë dallim nuk do të bëhet në bazë të statusit politik, juridik ose ndërkombëtar të shtetit ose vendit të cilit i përket çdo njeri, qoftë kur shteti ose vendi është i pavarur, qoftë nën kujdestari, qoftë jo vetëqeverisës ose që gjendet në çfarëdo kushtesh të tjera të kufizimit të sovranitetit.*

<sup>91</sup> Nowak, M. (2003). Introduction to the international human rights regime. Leiden: Brill Academic Publishers, p. 1-3.

<sup>92</sup> Idem, p. 35.

<sup>93</sup> Idem, p. 27.

<sup>94</sup> Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, mbledhja plenare e 138 e Asamblesë së Kombeve të Bashkuara 10.12.1948. [https://www.un.org/en/ga/search/vieë\\_doc.asp?symbol=A/RES/217\(III\)](https://www.un.org/en/ga/search/vieë_doc.asp?symbol=A/RES/217(III))

Diskriminimi mund të shfaqet si pasojë e shkaqeve të ndryshme që lidhen me racën, etninë, kombësinë, përkatësinë sociale, besimin fetar, orientimin seksual, moshën etj. të cilat konsiderohen karakteristika të mbrojtura.

Aktualisht ekziston një kuadër ligjor i gjerë ndërkombëtar në funksion të mbrojtjes kundër diskriminimit. Në aspektin territorial të veprimit ky kuadër mund të ndahet në:

- a) Marrëveshje ndërkombëtare me karakter të përgjithshëm; dhe
- b) Marrëveshje ndërkombëtare me karakter rajonal.

### 1. KUADRI NDËRKOMBËTAR PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Në vazhdim të këtij Manuali do të ndalemi të sqarojmë kuadrin rregullues të së drejtës ndërkombëtare në lidhje me mbrojtjen e qytetarëve nga diskriminimi.

#### ❖ KOMBET E BASHKUARA

Marrëveshjet ndërkombëtare, që garantojnë mbrojtjen nga diskriminimi janë hartuar dhe miratuar duke u frymëzuar nga DUDNj. Këto marrëveshje kanë mekanizma kontrolli që konsistojnë në Komitete të përbëra kryesisht nga 18 ekspertë të pavarur secili. Ndërkohë, Shtetet Palë në këto instrumente janë të detyruara të raportojnë periodikisht përpara këtyre Komiteteve. Për qëllime të këtij botimi do të paraqesim një panoramë e përgjithshme e Konventave më të rëndësishme që garantojnë mbrojtjen nga diskriminimi, duke shpjeguar shkurtimisht secilën prej tyre.

**Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor** (1965) ndëshkon diskriminimin për shkak të racës dhe garanton eliminimin e diskriminimit racor në të gjitha format e tij<sup>95</sup>. Kjo Konventë jo vetëm ndalon diskriminimin për shkak të racës në përgjithësi, por edhe çdo ndalim bazuar në racë, ngjyrë, prejardhje, origjinë kombëtare ose etnike<sup>96</sup>. Mekanizmi monitorues i kësaj Konvente është Komiteti për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor i cili përbëhet nga 18 ekspertë të pavarur<sup>97</sup>. Ndërkohë, shtetet palë në këtë Konventë kanë

<sup>95</sup> <https://rightsinfo.org/explainer-convention-elimination-race-discrimination/> [konsultuar më 08.03.2019].

<sup>96</sup> Nowak, M. (2003). Introduction to the international human rights regime. Leiden: Brill Academic Publishers, p. 83.

<sup>97</sup> <https://www.ohchr.org/EN/HRBodies/CERD/Pages/Membership.aspx> [konsultuar më 08.03.2019].

detyrim të paraqesin një raportim periodik dhe të adresojnë rekomandimet specifike, që i janë bërë nga Komiteti<sup>98</sup>. Kjo Konventë është pjesë e sistemit të brendshëm juridik shqiptar pasi është ratifikuar me ligj sipas parashikimeve kushtetuese<sup>99</sup> në vitin 1993<sup>100</sup>.

**Pakti Ndërkombëtar i të Drejtave Civile dhe Politike (1966)**<sup>101</sup> thekson edhe një herë barazinë e shtetasve përpara ligjit dhe ndalimin e çdo diskriminimi, duke siguruar mbrojtje të barabartë dhe efektive.

Pakti ka parashikuar mekanizma që sigurojnë zbatimin e të drejtave të parashikuara në të:

- a) raporte të detyrueshme vjetore nga shtetet palë pranë Komitetit të të Drejtave të Njeriut;
- b) ekziston mundësia për të kryer hetime në lidhje me ankesat e individëve në ato shtete që kanë ratifikuar Protokollin 1 të Paktit.

Edhe ky instrument ndërkombëtar është pjesë e sistemit juridik shqiptar pasi është ratifikuar<sup>102</sup> me ligj.

**Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (1969)**<sup>103</sup> përfshin gjithashtu në dispozitat e tij mbrojtjen nga diskriminimi dhe zbatimin e tij për të gjithë shtetasit e shteteve palë pa asnjë dallim në marrëdhënie, që përfshijnë fushën ekonomike, sociale dhe kulturore. Ky akt në nenin 3 sanksionon barazinë e burrit dhe gruas përpara ligjit, ku shtetet palë zotohen të sigurojnë të drejtën e barabartë të burrit dhe të gruas për t'i gëzuar të gjitha të drejtat ekonomike, shoqërore e kulturore të garantuara prej tij. Neni 5 thekson se Pakti i shtrir efektet tek të gjithë individëve pa asnjë lloj diskriminimi:

*“Asgjë në këtë Pakt nuk mund të interpretohet asisoj sikur i njuh një shteti, një grupi ose një personi çfarëdo të drejte për të ndërmarrë ndonjë veprimtari ose për të kryer një veprim duke pasur për qëllim zhdukjen e të drejtave dhe të lirive të njohura në këtë Pakt ose kufizime më të gjëra se sa ato të parashikuara në këtë Pakt.”*

Mekanizmi monitorues i Paktit është Komiteti mbi të Drejtat

<sup>98</sup> Konventa Ndërkombëtare për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor, neni 9.

<sup>99</sup> Në kohën e ratifikimit të Paktit Kushtetuta aktuale e RSH nuk ishte miratuar. Kushtetuta parashikon në nenin 122 § 1 pozicionin e marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara si pjesë e sistemit të brendshëm juridik.

<sup>100</sup> Ligji nr. 7768 datë 09.11.1993 „Për ratifikimin e Konventës Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor”.

<sup>101</sup> Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike u miratua më 16.12.1966.

<sup>102</sup> Ligji nr. 7510 datë 08.08.1991 „Për ratifikimin e Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike”.

<sup>103</sup> Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike Sociale dhe Kulturore u miratua më 16.12.1966.

Ekonomike Sociale dhe Kulturore<sup>104</sup>, i cili përbëhet nga 18 ekspertë të pavarur. Shqipëria ratifikoi paktin në gusht 1991<sup>105</sup> dhe prej momentit që ai hyri në fuqi ka detyrim të raportojë përpara Komitetit.

**Konventa mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (1979)**<sup>106</sup> ndryshe njohur si CEDAW është një ndër instrumentet më të rëndësishme në nivel ndërkombëtar që garanton barazinë gjinore dhe mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të gjinisë [dhe formave të tjera që mund të shfaqen]. Kjo Konventë nënvizoi edhe një herë garantimin e barazisë dhe mosdiskriminimit për shkak të gjinisë. Në nenin 1 të saj është përcaktuar se *diskriminim ndaj grave do të konsiderohet çdo dallim, përjashtim ose kufizim që bëhet në bazë të gjinisë dhe që ka për pasojë ose për qëllim të dëmtoj ose të shfuqizoj njohjen, gëzimin ose ushtrimin nga gratë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore etj.* Në zbatim të parashikimeve të Konventës çdo shtet raporton përpara Komitetit CEDAW në lidhje me të gjitha masat e ndërmarra për të garantuar barazinë gjinore të grave dhe zbatimin e parashikimeve të Konventës në praktikë.

Kjo është e para Konventë e OKB-së që detyron shtetet palë të modifikojnë dhe heqin dorë prej qëndrimeve sociale, modeleve dhe praktikave kulturore, të cilat mbështeten në idenë e inferioritetit apo superioritetit të secilit seks<sup>107</sup>. Ndërkohë, Protokollin shtesë i CEDAW i cili solli dy risi kryesore atë të komunikimit individual dhe procedurës së hetimit është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së më 6 tetor 1999. Shqipëria e ka ratifikuar<sup>108</sup> CEDAW dhe Protokollin shtesë<sup>109</sup>, duke marrë kështu përsipër detyrimin e raportimit periodik. Megjithëse, viti i ratifikimit të CEDAW është tepër i hershëm vetëm në vitin 2008 Kuvendi arriti të miratojë ligjin për barazinë gjinore<sup>110</sup>.

**Konventa për të Drejtat e Fëmijës (1989)**<sup>111</sup> garanton trajtim të

<sup>104</sup> Komiteti u krijua me Rezolutën 1985/17 të ECOSOC. <https://www.ohchr.org/en/hrbodies/cescr/pages/cescrindex.aspx> [konsultuar më 08.03.2019].

<sup>105</sup> Ligji nr. 7511 datë 08.08.1991 „Për ratifikimin e Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike Sociale dhe Kulturore

<sup>106</sup> Konventa mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave u miratua më 18.12.1979.

<sup>107</sup> Bernard, A. & Mandro, A. & Anastasi, A. (2009). Çështje të barazisë gjinore në standardet ligjore dhe jurisprudencën kombëtare dhe ndërkombëtare – Udhëzues. Tiranë: botimet Pegi, fq. 9.

<sup>108</sup> Ligji nr. 7769 datë 9.11.1993 „Për ratifikimin e Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Gjinor”.

<sup>109</sup> Bernard, A. & Mandro, A. & Anastasi, A. (2009). Çështje të barazisë gjinore në standardet ligjore dhe jurisprudencën kombëtare dhe ndërkombëtare – Udhëzues. Tiranë: botimet Pegi, fq. 11.

<sup>110</sup> Ligji nr. 9970 datë 24.7.2008 „Për barazinë gjinore në shoqëri”.

<sup>111</sup> Konventa për të Drejtat e Fëmijës u miratua më 20 nëntor 1989.



barabartë për fëmijët duke shmangur të gjitha format e diskriminimit ose ndëshkimit të tyre. Kjo Konventë ju vendos shteteve anëtare detyrimin për tëndërmarrë të gjitha masat e nevojshme dhe të përshtatshme për të siguruar që fëmija të jetë i mbrojtur nga të gjitha format e diskriminimit ose ndëshkimit për shkak të: *pozitës, opinioneve të shprehura bindjeve të prindërve ose anëtarëve të tjerë të familjes*. Edhe monitorimi i këtij instrumenti ndërkombëtar bëhet nga një Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve, i cili përbëhet nga 18 ekspertë të pavarur. Konventa është pjesë e sistemit ligjor shqiptar prej ratifikimit në vitin 1991<sup>112</sup>.

**Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Protokollin Opsional (2012)**<sup>113</sup> parashikon parimet e mbrojtjes së dinjitetit, autonomisë individuale, mosdiskriminimit, pjesëmarrjen dhe përfshirjen në shoqëri. Mekanizmi monitorues i KDPAK është gjithashtu një Komitet i përbërë nga 18 ekspertë të pavarur, të cilët janë edhe vetë me aftësi të kufizuara. Në kuadër të kësaj Konvente Shqipëria<sup>114</sup> ka ndërmarrë detyrime për të respektuar, mbrojtur dhe përmbushur të drejtat e personave me aftësi të kufizuara<sup>115</sup>. Me qëllim zbatimin e parashikimeve të Konventës dhe mbrojtjen nga diskriminimi të këtij grupi personash është miratuar një ligj i posaçëm<sup>116</sup> për të garantuar përfshirjen dhe aksesueshmërinë e tyre.

## ❖ KËSHILLI I EVROPËS

Mbrojtja nga diskriminimi në Evropë garantohet nga instrumentet e miratuara nga Këshilli i Evropës (KiE) dhe Bashkimi Evropian (BE). Megjithatë, për qëllime të këtij manuali do të ndalemi vetëm në aktet e miratuara nga KiE, pjesa më e madhe e të cilave janë të zbatueshme edhe në sistemin tonë ligjor.

**KiE** është një organizatë ndërkombëtare e krijuar pas Luftës së Dytë Botërore me qëllim mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të të gjithëindividëve në kontinentin e vjetër.

Instrumenti mbi të cilin është krijuar dhe vepron Këshilli është Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila përbën katalogun bazë të lirive dhe të drejtave në 47 vendet anëtare të KiE.

<sup>112</sup> Ligjin nr.7531 datë 11.12.1991 "Për Ratifikimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijës".

<sup>113</sup> Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, miratuar më 13 dhjetor 2006 dhe Protokollin i saj Opsional i miratuar më 15 nëntor 2012.

<sup>114</sup> Ligji nr. 108/2012 "Për ratifikimin e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara".

<sup>115</sup> Kumbo, D. (2016). Përmbledhje e rasteve mbi aftësinë e kufizuar në Jurisprudencën e Gjykatës së Strasburgut. Tiranë: UNDP. fq. 9.

<sup>116</sup> Ligji 93/2014 "Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara (ligji kuadër)".

Konventa është e ndërtuar në tre pjesë kryesore:

- a) Neni 1;
- b) Seksioni I: Liritë dhe të drejtat
- c) Seksioni II: Gjykata.

Sa i takon seksionit të dytë, KEDNJ në dispozitat e saj të Titullit Ilka parashikuar krijimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), si një mekanizëm kontrolli dhe autoriteti i vetëm, që mund të interpretojë të Konventën<sup>117</sup>. GJEDNJ është vlerësuar si një mekanizëm kontrolli tepër efektiv, pasi jurisprudenca e saj është e zbatueshme në të gjitha shtetet palë në Konventë. Përpos evidentimit të shkeljeve në lidhje me të drejtat dhe liritë e parashikuara në Konventë, Gjykata i akordon kërkuarve dhe një shpërbim të drejtë i cili paguhet nga shteti i paditur në rastet kur evidentohet shkelje.<sup>118</sup> Ndërkohë, një strukturë tjetër pjesë e KiE, specifikisht Komiteti i Ministrave monitoron zbatueshmërinë e vendimeve të Gjykatës në llogari të shteteve të paditura<sup>119</sup>. Ndërkohë, të drejtat themelore të garantuara në seksionin e parë ndahen në të drejta absolute, të drejta procedurale, të drejta materiale dhe të drejta të tjera<sup>120</sup>.

Në lidhje me ndalimit të diskriminimit KEDNJ në nenin 14 i saj sanksionon se:

*"Gëzimi i të drejtave dhe lirive të përcaktuara në Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër".*

Në terma të përgjithshëm Strasburgu ka konsideruar se gjendemi përballë **diskriminimit kur individët janë përballur me trajtim të ndryshëm në situata relativisht të ngjashme**, trajtim ky i cili nuk është justifikuar objektivisht dhe nuk është proporcional<sup>121</sup>. Gjithashtu, Gjykata ka cilësuar si **diskriminim** situatat në të cilat **individët janë përballur me trajtim të njëjtë kur në fakt trajtimi duhet të ishte i diferencuar**<sup>122</sup>.

<sup>117</sup> Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nenin 19 dhe 32.

<sup>118</sup> Idem, neni 41.

<sup>119</sup> Idem, neni 54.

<sup>120</sup> Mole, N. & Kamber, K. & Liaki, V. (2018). Drejt një zbatimi efektiv në nivel kombëtar të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Beograd: AIRE Centre, f. 18-27.

<sup>121</sup> Harris, & O'Boyle & Warbrik. (2014). The law of the European Convention on Human Rights. United Kingdom: Oxford University Press. p. 786.

<sup>122</sup> Thlimmenos k. Greqisë, vendim i Dhomës së Madhe i 6 prillit 2000, nr. 34369/97, paragrafi 44.

Garancitë e nenit 14 të Konventës janë zgjeruar me ratifikimin dhe hyrjen në fuqi të Protokollit 12<sup>123</sup>, i cili ndalon në mënyrë të përgjithshme diskriminimin. Ky protokoll veçanërisht zgjeron gamën e mbrojtjes nga diskriminimi për të përfshirë detyrimin negativ të shteteve palë për ta njohur këtë të drejtë, si edhe një detyrim pozitiv për të marrë masa për mbrojtje nga diskriminimi, edhe kur diskriminimi ndodh midis palëve private<sup>124</sup>. Megjithatë, Protokollin 12 ende nuk ndalon të gjitha format e diskriminimit, por vetëm në lidhje me të drejtat "të parashtruara në legjislacionet kombëtare"<sup>125</sup>.

Kështu, mbrojtja nga diskriminimi në kuadër të Konventës është një mbrojtje me karakter plotësues, duke mos krijuar kështu një parim të përgjithshëm dhe të pavarur të trajtimit të barabartë<sup>126</sup>. Me këtë karakter plotësues duhet kuptojmë faktin se kjo dispozitë garanton mbrojtjen nga diskriminimi vetëm për të drejtat e tjera të garantuara nga KEDNJ.

Parimet kryesore të mbrojtjes nga diskriminimi janë nënvizuar në vendimin *Çështja Gjuhësore Belge*, ku Gjykata e Strasburgut vendosi se ndalimi i diskriminimit është pjesë integrale e secilës prej të drejtave dhe lirive të parashikuara në Konventë<sup>127</sup>.

Në *Çështjen Gjuhësore Belge* njëri prej kërkuessve u ankua se nuk kishte të drejtën e aksesit në një shkollë publike, pasi institucionet arsimore publike nuk ofronin programe në gjuhën e tij. Në këtë rast Gjykata vërejtë se vërtetë Konventa nuk detyron shtetet palë të ofrojnë një sistem arsimor të caktuar, por një herë që kjo e drejtë iu është njohur qytetarëve, shteti nuk mund të tërhiqet nga detyrimet e tij të cilat kanë rrjedhur kjo e drejtë, duke diskriminuar kërkuessit vetëm për shkak të gjuhës.

<sup>123</sup> Protokollin nr. 12 i KEDNJ (ETS nr. 177) u hartua më 4/11/2000 dhe hyri në fuqi më 1/04/2005 pas ratifikimit të nga 10 shtete anëtare të Këshillit të Evropës.

<sup>124</sup> Bernard, A. & Mandro, A. & Anastasi, A. (2009). *Çështje të barazisë gjinore në standardet ligjore dhe jurisprudencën kombëtare dhe ndërkombëtare* – Udhëzues. Tiranë: botimet Pegi, f. 17.

<sup>125</sup> Mole, N. & Kamber, K. & Liaki, V. (2018). *Drejt një zbatim të efektiv në nivel kombëtar të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*. Beograd: AIRE Centre. fq.27

<sup>126</sup> Bernard, A. & Mandro, A. & Anastasi, A. (2009). *Çështje të barazisë gjinore në standardet ligjore dhe jurisprudencën kombëtare dhe ndërkombëtare* – Udhëzues. Tiranë: botimet Pegi, f. 15.

<sup>127</sup> *Çështja Gjuhësore Belge*. Belgjikës, vendimi i 23 korrikut 1968, nr. 1474/62, 1677/62, 1691/62, 1769/63, 1994/63 dhe 2126/64.

Më tej, në standardet e parashikuara nga GJEDNJ është vendosur se mund të evidentohet shkelje e nenit 14 edhe nëse nuk ka shkelje të së drejtës thelbësore me të cilën ai lidhet, për sa kohë çështja objekt gjykimi përfshihet në fushëveprimin e një të drejte që garantohet nga KEDNJ<sup>128</sup>.

Për të përcaktuar nëse gjendemi përballë një situatë diskriminimi Gjykata u jep përgjigje **katër pyetjeve**<sup>129</sup>:

- 1) A gjendemi përballë një trajtimi të ndryshëm kur situatat janë të krahasueshme me njëra-tjetrën?
- 2) A bazohet diskriminimi në një karakteristikë të mbrojtur nga neni 14?
- 3) A ndiqet trajtimi i ndryshëm nga një qëllim legjitim?
- 4) A është zbatuar parimi i proporcionalitetit në lidhje me trajtimin e ndryshëm të individëve?

Për ta konkretizuar qëndrimin e Gjykatës së Strasburgut mbi mbrojtjen e çdo individi nga diskriminimi në lidhje me të drejtat dhe liritë themelore në pjesën e fundit të këtij manuali do të paraqesim një përmbledhje të disa prej vendimeve më të rëndësishme në lidhje me karakteristikat e mbrojtura.

Përpos Konventës Evropiane, KiE ka miratuar edhe një sërë konventash të tjera, një pjesë e së cilave garantojnë mbrojtjen nga diskriminimi.

**Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës kundër Grave dhe Dhunës në Familje**(2011) - KiE ka ndërmarrë një sërë iniciativash për promovimin e mbrojtjes së grave kundër dhunës. Si rezultat i këtyre iniciativave u miratua Rekomandimi Rec (2002) 5 e Komitetit të Ministrave të KiE për mbrojtjen e grave kundër dhunës dhe për realizimin e një fushate dyvjeçare në mbarë Evropën, për të luftuar dhunën ndaj grave, duke përfshirë dhunën në familje<sup>130</sup>. Asambleja Parlamentare ka marrë gjithashtu një qëndrim politik të fortë kundër të gjitha formave të dhunës kundër grave. Ajo ka miratuar një sërë rezolutash dhe rekomandimesh që kërkojnë standarde ligjrisht të detyrueshme për

<sup>128</sup> Mole, N. & Kamber, K. & Liaki, V. (2018). *Drejt një zbatim të efektiv në nivel kombëtar të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*. Beograd: AIRE Centre. fq.27

<sup>129</sup> Harris, & O`Boyle & Warbrik. (2014). *The law of the European Convention on Human Rights*. United Kingdom: Oxford University Press. p. 788-796.

<sup>130</sup> <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/210>

parandalimin, mbrojtjen dhe ndjekjen e formave më të rënda dhe më të përhapura të dhunës me bazë gjinore.<sup>131</sup> Shqipëria ishte vendi i dytë që ratifikoi<sup>132</sup> këtë Konventë njohur ndryshe si Konventa e Stambollit, në fillim të vitit 2013, e cila hyri në fuqi më 1 gusht, 2014 pa asnjë rezervë.<sup>133</sup>

**Karta Sociale Evropiane** (1961) është një traktat që plotëson parashikimet e KEDNJ-së në fushën e të drejtave sociale dhe ekonomike, i cili është rishikuar në 1996<sup>134</sup>. Karta mbron të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, njohur ndryshe si gjenerata e dytë e të drejtave, të cilat nuk kanë marrë të njëjtën vëmendje nga shtetet palë krahasuar me KEDNJ. Ndërkohë, Protokollit shtesë i saj garanton të drejta të tjera tepër të rëndësishme si mbrojtja gjithë përfshirëse nga diskriminimi dhe mbrojtja nga varfëria. Shtetet palë mund ta ratifikojnë këtë instrument me rezervë njohur ndryshe si ratifikim “à la carte<sup>135</sup>” “Mekanizmi monitorues i Kartës është Komisioni Evropian i të Drejtave Sociale. Karta Sociale Evropiane (e rishikuar) është ratifikuar në 2002, por ratifikimi nuk është bërë për të gjithë nenet e Kartës.<sup>136</sup>

**Konventa Kuadër e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare** (1995) ka qëllim sigurimin e zbatimit të parimeve të barazisë dhe mosdiskriminimit për personat që i përkasin pakicave kombëtare. Kjo Konventë përcakton detyrimin për palët nënshkruese që të ndër marrin masa pozitive specifike në mbrojtje të minoriteteve që jetojnë brenda juridiksionit të këtyre shteteve<sup>137</sup>. Shqipëria e ka ratifikuar Konventën Kuadër të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare në 1999.<sup>138</sup>

<sup>131</sup> file:///C:/Users/kkllapi/Downloads/area-of-justice-and-fundamental-rights\_eu-accession-to-the-istanbul-convention\_2019-05-01.pdf

<sup>132</sup> Ligji Nr. 104/2012, “Për Ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për Parandalimin dhe Luftën Kundër Dhunës Ndaj Grave dhe Dhunës në Familje”.

<sup>133</sup> [https://www.womenlobby.org/IMG/pdf/ewl-albania\\_report\\_web.pdf](https://www.womenlobby.org/IMG/pdf/ewl-albania_report_web.pdf)

<sup>134</sup> Rishikimi i Kartës njihet si RevESC.

<sup>135</sup> Frëngjisht. Ratifikimi mund të bëhet edhe vetëm për disa nene, jo për dokumentin në tërësi ku shteti merr përsipër të zbatojë parashikimet e Kartës.

<sup>136</sup> Ligji nr. 8960, datë 24.10.2002 “Për Ratifikimin e Kartës Sociale Evropiane, e ndryshuar”.

<sup>137</sup> Nowak, M. (2003). Introduction to the international human rights regime. Leiden: Brill Academic Publishers, p. 181.

<sup>138</sup> Ligji nr. 8496, datë 03.06.1999, “Për Ratifikimin e Konventës Kuadër të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare”.

## VENDIME TË GJEDNJ-SË NË LIDHJE ME NENIN 14 TË KEDNJ-SË

### KUOA POIRREZ k. FRANCËS

(kërkesa nr. 40892/98)

#### Çështja trajton diskriminimin mbi baza shtetësie në lidhje me trajtimin financiar të PAK

**Faktet** - EttienLaurentKouaPoirrez është shtetas i Bregut të Fildishtë banues në Paris dhe i adoptuar nga një shtetas francez më 1987. Z. KouaPoirrez ishte 80% invalid. Më 1990 Zyra e Mbështetjes së Familjeve refuzoi t'i akordonte atij trajtimin financiar të një invalidi madhor me arsyetimin se ai nuk ishte shtetas francez dhe se nuk kishte ndonjë marrëveshje dypalëshe ndërmjet Francës dhe Bregut të Fildishtë në lidhje me një trajtim të tillë. Kërkuesi e kundërshtoi këtë qëndrim përpara gjykatave franceze por pa sukses. Pas miratimit të një ligji të posaçëm, i cili e hiqte kushtin e shtetësisë për përfitimin e trajtimeve jo-kontributive, kërkuesi bëri një kërkesë të re për të përfituar trajtimin e një invalidi madhor (T.I.M.) i cili iu akordua dhe iu hoq. Kërkuesi u ankua në GJEDNJ për shkelje të nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) të Konventës të marrë së bashku me nenin 1 të Protokollit 1 (mbrojtja e pronës) për shkak të refuzimit të autoriteteve franceze për t'i akorduar atij një trajtimin e një invalidi madhor (T.I.M.). Gjithashtu, ai u ankua në kuadër të nenit 6 § 1 (e drejta për një proces të rregullt) në lidhje me kohëzgjatjen e procesit gjyqësor në Francë.

**Vendimi** - Gjykata vendosi se një përfitim jo-kontributiv i një lloji si T.I.M. hyn në fushën e zbatimit të një të drejte me karakter pasuror për qëllimet e nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës. Fakti që vendi i origjinës së kërkuesit nuk kishte nënshkruar një marrëveshje reciproke – ndërkohë që vetë kërkuesit i ishte dhënë një dokument që vërtetonte invaliditetin e tij, duke shtuar këtu faktin se ai jetonte në Francë si biri i adoptuar i një shtetasi francez – nuk mund të justifikonte refuzimin që atij t'i paguhej trajtimi i pretenduar. Kriteri i shtetësisë si kusht për akordimin e këtij përfitimi ishte

shfuqizuar me ligjin e 11 majit 1998 dhe kërkesit i ishte akorduar T.I.M. menjëherë pas miratimit të këtij ligji. Për këtë arsye Gjykata vlerësoi se kërkesi kishte pasur një të drejtë me karakter pasuror për qëllimet e nenit 1 të Protokollit 1 dhe se neni 14 i Konventës gjente gjithashtu zbatim duke pasur parasysh kriterin që përdorej si justifikim për mos akordimin e TIM. Gjykata vërejtë se nuk kishte ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për dallimin në trajtim ndërmjet shtetasve francezë ose shtetasve të vendeve të kishin nënshkruar marrëveshje dypalëshe dhe të huajve të tjerë. Edhe pse në kohën e ngjarjeve Franca nuk kishte ndonjë marrëveshje dypalëshe me Bregun e Fildishtë, duke ratifikuar Konventën ajo kishte marrë përsipër t'i siguronte çdokujt brenda juridiksionit të saj – dhe këtu hynte padyshim edhe kërkesit – të drejtat dhe liritë e parashikuara në Seksionin I të Konventës. Për këtë arsye Gjykata vendosi se ka pasur shkelje të nenit 14 të Konventës të marrë së bashku me nenin 1 të Protokollit 1.

#### **FABRIS k. FRANCËS**

*(kërkesa nr. 16574/08)*

#### **Dhomë e Madhe**

#### ***Çështja trajton të drejtat e trashëgimisë midis vëllezërve dhe motrave brenda dhe jashtë martesë***

**Faktet** - Kërkesi, Henry Fabris, u lind në vitin 1943. Në kohën e ngjizjes nëna e tij ishte martuar me Z. M., me të cilin ajo kishte dy fëmijë. Në vitin 1970 Z. dhe Znj M. nënshkruan një akt të ndarjes së pasurisë *intervivos* duke e ndarë pronën e tyre ndërmjet dy fëmijëve të lindur prej martesës. Në vitin 1983 - kur ishte 40 vjeç z. Fabris u shpall ligjërisht fëmija "jolegjitim" i zj. M. Pas vdekjes së nënës së tij në vitin 1994, ai kërkoi shfuqizimin e aktit të ndarjes të pasurisë *intervivos*, duke pretenduar se i takonte një pjesë e barabartë pasurie me atë që u takonte fëmijëve të tjerë të nënës së tij. Gjykata vendose vendosi në vitin 2004 në favor të tij në bazë të neneve 8 dhe 14 të KEDNJ-së. Fëmijët e lindur nga martesë e zj. M, apeluan dhe Gjykata e Apelit vendosi më prishjen e vendimit të gjykatës më të ulët me arsyetimin se, sipas ligjit të vitit francez të 1972, pasuritë *intervivos* të ndara para datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji nuk mund të kundërshtoheshin dhe në rastin konkret akti i ndarjes *intervivos* ishte nënshkruar në vitin 1970. Sipas Gjykatës së Apelit, kishte një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për këtë rregull në dritën e qëllimit legjitim të ndjekur, domethënë, garantimin e

marrëdhënieve paqësore familjare duke siguruar të drejtat të përfituara në atë kontekst – në rastin konkret të përfituara prej shumë kohësh. Ankimi i kërkesit u rrëzua nga Gjykata e Kasacionit.

**Vendimi i Gjykatës** - Në vendimin e Dhomës të datës 21 korrik 2011, Gjykata u shpreh se nuk ka pasur shkelje të nenit 14 i shqyrtuar në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës. Kërkesi pretendoi para Dhomës së Madhe se dallimi në të drejta, bazuar mbi lindjen brenda ose jashtë kornizës martesore ishte një shkelje e të drejtës së tij për barazi, në kundërshtim me nenin 14 dhe të drejtës së tij për gëzimin e pronës së tij, në kundërshtim me nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës. Gjykata përsëriti se kërkohen arsye shumë të mëdha, që një dallim i bazuar në lindjen jashtë ose brenda martesë për fëmijët të mund të konsiderohet si i pajtueshëm me Konventën. Ligji mbi të cilën trajtimi i kërkesit u bazua, e kufizonte të drejtën e trashëgimisë të fëmijëve "të lindur nga shkelja e kurorës". Kështu, arsyeja e vetme për dallim në trajtim ishte fakti se kërkesi ishte fëmijë i lindur jashtë martesë. Ndërkohë, që Gjykata u ndal të shqyrtonte se deri në çfarë mase diferenca në fjalë në trajtimin e kërkesit ndiqte një qëllim legjitim, Gjykata vërejtë se Franca kishte rishikuar legjislacionin e saj në përputhje me parimin e Konventës për mosdiskriminimin e fëmijëve për shkak të lindjes. Ajo gjithashtu vërejtë se, mbrojtja e të drejtave të fituara mund t'i shërbejë interesit të sigurisë juridike. Në fakt, qeveria kishte argumentuar se, shqetësimi për të mos cenuar të drejtat e fituara nga trashëgimtarët justifikonte kufizimin e efektitin prapaveprues të ligjit të vitit 2001 për trashëgimin, që nuk shtrihej edhe mbi ndarjet e pasurisë deri në atë datë. Sipas Gjykatës, ky ishte një qëllim legjitim i aftë për të justifikuar dallimin në trajtim në rastin konkret, duke mos sjellë kështu diskriminim në kuadër të nenit 14 marrë së bashku me nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës.

#### **X DHE TË TJERË k. AUSTRIË**

*(kërkesa nr. 19010/07)*

#### **Dhomë e Madhe**

***Pamundësia e birësimit nga bashkëjetuesi në një marrëdhënie të seksit të njëjtë në Austri përbën diskriminim në krahasim me situatën e çifteve të pamartuara të sekseve të ndryshme***

**Faktet** - Kërkuessit janë dy gra austriake ("kërkuessja e parë dhe e tretë") të cilat jetojnë në një marrëdhënie të qëndrueshme homoseksuale dhe i biri i njëres prej tyre ("kërkuessi i dytë"). Ky i fundit, fëmijë i lindur jashtë martese në vitin 1995 dhe e ëma e tij, e cila ka kujdestarinë e plotë të tij. Kërkuessit jetojnë së bashku dhe dy gratë bashkërisht kujdesen për fëmijën. Duke dashur të krijonin një marrëdhënie juridike ndërmjet kërkuesses së parë dhe fëmijës, pa ndërprerë marrëdhënien që ai kishte me nënën e tij, ata arritën një marrëveshje birësimi në shkurt 2005 dhe e dorëzuan atë në gjykatën kompetente të rrethit për miratim. Duke qenë të vetëdijshëm se dispozitat përkatëse të Kodit Civil mund të kuptoheshin sikur përjashtonin birësimin e fëmijës së partnerit nga partneri tjetër në një çift homoseksual, pa ndërprerë marrëdhënien me prindin biologjik, kërkuessit i kërkuuan Gjykatës Kushtetuese t'i shpallte ato dispozita antikushtetuese, me argumentin se ishin diskriminuese ndaj tyre për shkak të orientimit seksual. Gjykata Kushtetuese e hodhi poshtë kërkesën si të papranueshme në qershor 2005, duke argumentuar se ishte në pritje të vendimit të gjykatës së rrethit. Në tetor 2005, gjykata e rrethit refuzoi të miratonte marrëveshjen e birësimit. Kërkuessit apeluan ndaj këtij vendimi por ai u hodh poshtë nga gjykata rajonale në shkurt 2006. Në shtator 2006, Gjykata e Lartë hodhi poshtë ankesën e kërkuessve për çështje të ligjit, duke vendosur se birësimi i fëmijës nga partneri femër i nënës së tij ose të saj ishte ligjërish i pamundur. Kërkuessit u ankuan bazuar në nenin 14 marrë së bashku me nenin 8 të Konventës me argumentin se diskriminoheshin për shkak të orientimit seksual. Ata parashtuan se nuk kishte asnjë përligje të arsyeshme dhe objektive për të lejuar birësimin e fëmijës së partnerit nga partneri tjetër tek çiftet heteroseksuale, qofshin ata të martuar ose jo dhe të ndalohej e njëjta praktikë në rastin e çifteve homoseksual.

**Vendimi** - Gjykata pranoi se kërkuessit ishin në një situatë të ngjashme me atë të një çifti të pamartuar me partnerë të sekseve të ndryshme, ku njëri prej tyre dëshironte të birësonte fëmijën e partnerit tjetër. E drejta austriake e lejonte birësimin e fëmijës së partnerit në rastet e një çifti të pamartuar me partnerë të sekseve të ndryshme. Ndërkohë, që birësimi i fëmijës së partnerit në rastin e çifteve homoseksuale ishte ligjërish i pamundur. Nuk kishte asnjë detyrim sipas nenit 8 të Konventës për të shtrirë të drejtën për birësimin e fëmijës së partnerit për çiftet e pamartuara. Duke qenë se e drejta austriake lejonte birësimin e fëmijës së partnerit në rastin e çifteve heteroseksuale të pamartuara, Gjykata duhej të shqyrtonte nëse kjo e drejtë për të çiftet e të njëjtit seks i shërbente një

qëllimi legjitim dhe ishte në proporcion me të. Gjykata konstatoi se qeveria nuk kishte parashtuar arsye bindëse për të treguar se përjashtimi nga e drejta për të birësuar fëmijën e partnerit për çiftet e të njëjtit seks dhe lejimi i të njëjtës situatë për çiftet e pamartuara me partnerë heteroseksualë ishte e nevojshme për mbrojtjen e familjes në kuptimin tradicional apo për mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës. Prandaj, dallimi përbënte diskriminim. Gjykata vendosi me shumicë se ka pasur shkelje të nenit 14 i shqyrtuar në lidhje me nenin 8 të Konventës.

## **OPUZ k. TURQISË**

*(kërkesa nr. 33401/02)*

### ***Dhuna në familje dhe detyrimet që i linden autoriteteve shtetërore në raste të tilla***

**Faktet** - Kërkuessja ishte një shtetase turke, e cila së bashku me nënën e saj, kishte përjetuar dhunë dhe keqtrajtim të vazhdueshëm nga ish-bashkëshorti i saj H.O. Kërkuessja kishte bërë disa herë denoncime në polici dhe kishte marrë vërtetimin nga mjeku për dëmtimet e pësuar, të cilat në disa raste ishin të tilla që vinin në rrezik jetën e saj dhe të ëmës. Policia kishte pushuar çështjen pas tërheqjes së denoncimit nga ana e kërkuesses, edhe pse kishte prova të mjaftueshme që dhuna kishte qenë e vazhdueshme dhe me intensitet të lartë, ndërkohë që kishte dënuar me gjobë H.O për dy raste dhune. H.O. u dënua me burgim të përjetshëm dhe armëmbajtje pa leje vetëm pas vrasjes së nënës së kërkuesses, e megjithatë u lirua gjatë procedurës në apel. Kërkuessja pretendoi se autoritetet turke kishin dështuar në mbrojtjen e të drejtës së jetës të nënës së saj dhe se ishin treguar neglizhentë përballë përsëritjes së dhunës dhe kërcënimeve për vdekje. Ajo gjithashtu u ankua për mangësitë e ligjit turk për të mbrojtur gratë nga dhuna në familje.

**Vendimi** - Gjykata u shpreh se kishte pasur shkelje të nenit 2 në dy aspekte: autoritetet e dinin, ose duhet ta kishin ditur ekzistencën e një rreziku real dhe të menjëhershëm për jetën e kërkuesses dhe nënës së saj, megjithatë nuk kishin marrë masa parandaluese kundër dhunës në familje dhe së dyti procedura për dënimin e H.O. për vrasjen e kryer kishte zgjatuar më shumë se 6 vite dhe nuk mund të konsiderohej efektive, sistemi ligjor penal nuk kishte pasur asnjë efekt parandalues në këtë rast.

Gjithashtu, Gjykata u shpreh se kishte pasur shkelje të nenit 3 për shkak të dështimit të autoriteteve për të marrë masa mbrojtëse në formën e ndalimit efektiv të cenimeve serioze të integritetit personal të kërkueses të pësuar nga ana e ish-bashkëshortit të saj. Gjykata konsideroi se kërkuesja kishte qenë në gjendje të vërtetonte se dhuna në familje prekte kryesisht gratë në komunitetin e saj dhe se pasiviteti diskriminues dhe i përgjithshëm nga gjykatat turke kishte krijuar një klimë që favorizonte dhunën në familje. Duke pasur parasysh këtë, dhuna e pësuar nga kërkuesja dhe mamaja e saj mund të konsiderohej si e bazuar tek gjinia, që përbënte një formë të diskriminimit kundër grave. Për rrjedhojë, Gjykata ishte shprehur për shkelje të nenit 14 në lidhje me nenet 2 dhe 3 të Konventës.

### **NACHOVA DHE TË TJERËT K. BULLGARISË**

*(kërkesat nr. 43577/98 dhe 43579/98)*

#### ***Vrasjet për arsye raciale të dy romëve në Bullgari***

**Faktet** - Çështja ka të bëjë me vrasjen e dy të rinjve romë, të afërm të kërkueseve, nga Majori G, i cili bashkë me katër oficerë të policisë gjyqësore ishte dërguar për të arrestuar dy viktimat. Dy viktimat ishin dënuar më parë për vepra penale jo të dhunshme. Komandanti i Rajonit të Policisë Ushtarake, kishte informuar oficerët e policisë ushtarake se viktimat ishin 'kriminelë aktivë'- term që përdorej për të përshkruar persona të dënuar më parë ose ato që dyshoheshin për kryerjen e krimeve - dhe se ato ishin larguar nga izolimi. Oficerët e policisë ushtarake ishin udhëzuar që të vishnin jelek antiplumb, të mbanin gati revolverët dhe automatikët si dhe gjithashtu të përdornin të gjitha mjetet e nevojshme që ti arrestonin ata. Ditën e arrestimit, dy të ikurit u përpoqën të largoheshin, por pas paralajmërimit të Majorit G se do t'i qëllonte në qoftë se nuk dorëzoheshin, Majori G qëlloi drejt tyre duke i lënë të vdekur. Sipas një dëshmitari të ndodhur në zonë, Majori G i kishte drejtuar armën duke i thënë 'Ju drej jevgjish'.

**Vendimi**- Gjykata vuri në dukje se viktimat kishin vuajtur dënime të shkurtra për vepra penale jo të dhunshme, se ato ishin larguar nga vendi i vuajtjes së dënimit pa përdorur dhunë dhe se asnjëri prej tyre nuk kishte qenë i armatosur. Në këtë kuadër, Gjykata vlerësoi se në asnjë rast nuk ishte e nevojshme që të përdoreshin armë zjarri të tilla për të

arrestuar këta persona, edhe kur mospërdorimi i armëve mund të çonte në dështimin e arrestimit të tyre. Gjykata vlerësoi se autoritetet bullgare nuk kishin respektuar detyrimin e tyre për të minimizuar rrezikun e humbjes së jetës, përderisa nuk kishin mbajtur parasysh natyrën e shkeljes dhe faktin që të dy djemtë nuk përbënin ndonjë rrezik. Gjithashtu, Gjykata konstatoi se hetimi u karakterizua nga një sërë mangësish serioze dhe të pashpjegueshme; ai u mbyll me një vendim që përmbante papajtueshmëri dhe konkluzione që nuk mbështeteshin në një analizë të kujdesshme të fakteve dhe për këto, Gjykata u shpreh se kishte pasur shkelje të nenit 2 dhe nenit 1 të Konventës. Në lidhje me nenin 14 Gjykata vuri re se nuk ishin marrë në analizë disa fakte të cilat duhet ti kishin alarmuar autoritetet dhe t'i kishin bërë ato të ishin veçanërisht vigjilentë për të hetuar arsye të mundshme raciste. Për këtë arsye, lidhur me faktin nëse diskriminimi kishte ndikuar në të shtënat me armë zjarri, Gjykata vlerësoi si tepër të rëndësishëm faktin se ky nuk ishte rasti i parë kundër Bullgarisë, në të cilin ajo kishte konstatuar se zyrtarë të ngarkuar me zbatimin e ligjit kishin ushtruar dhunë deri në vdekje ndaj romëve. Për rrjedhojë, Gjykata arriti në përfundimin se ka pasur shkelje të nenit 14 të marrë së bashku me nenin 2 të Konventës.

# Bibliografi

## LIGJE

- Ligj Nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligj Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligj Nr. 7995, datë 20.09.1995 “Për nxitjen e punësimit”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligj Nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”.
- Ligji nr. 7510 date 08.08.1991 „Për ratifikimin e Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike“.
- Ligji nr. 7511 datë 08.08.1991 „Për ratifikimin e Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore“.
- Ligjin nr.7531 datë 11.12.1991 “Për Ratifikimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijës”.
- Ligji nr. 7768 datë 09.11.1993 „Për ratifikimin e Konventës Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor“.
- Ligji nr. 7769 datë 9.11.1993 „Për ratifikimin e Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Gjinator“.
- Ligji nr. 8496, datë 03.06.1999, “Për Ratifikimin e Konventës Kuadër të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare”.
- Ligji nr. 8960, datë 24.10.2002 “Për Ratifikimin e Kartës Sociale Evropiane, e ndryshuar”.
- Ligj Nr. 9106, datë 17.07.2003 “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligj Nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 9970 datë 24.7.2008 „Për barazinë gjinore në shoqëri“.
- Ligj Nr. 10107, datë 30.03.2009 “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligj Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

- Ligji Nr. 104/2012, “Për Ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për Parandalimin dhe Luftën Kundër Dhunës Ndaj Grave dhe Dhunës në Familje”.
- Ligji nr. 108/2012 “Për ratifikimin e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”.
- Ligji 93/2014 “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara (ligji kuadër)”.
- Ligj Nr. 147/2014 “Për shërbimin e urgjencës mjekësore”.
- Ligj Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligj Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.
- Ligj Nr. 96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare”.

## TRAKTATE NDËRKOMBËTARE

- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, mbledhja plenare e 138 e Asamblesë së Kombeve të Bashkuara, 10.12.1948
- Konventa mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, 18.12.1979.
- Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, 21.12.1965.
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike u miratua më 16.12.1966.
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike Sociale dhe Kulturore u miratua më 16.12.1966.
- Konventa Kuadër e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Minoriteteve, 01.02.1995.
- Karta e të Drejtave të Pacientit.
- Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës kundër Grave dhe Dhunës në Familje, 11.05.2011.
- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, 4.11.1950, ndryshuar me Protokollet nr. 11 dhe 14, shoqëruar nga Protokollet nr. 1, 4, 6, 7, 12 e 13.
- Konventa për të Drejtat e Fëmijës 20.11.1989.
- Karta Sociale Evropiane, 18.10.1961 dhe Karta e Rishikuar 03.05.1996.
- Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 13.12.2006 dhe Protokolli i saj Opsional 15.11.2012.

## VENDIME GJYQËSORE

- Gjykata Kushtetuese
- Vendim Nr. 20, datë 11.07.2006
- Vendim Nr. 9, datë 26.02.2007
- Vendim Nr. 33, datë 12.09.2007

Vendim Nr. 17, datë 23.04.2010  
Vendim Nr. 33, datë 24.06.2010  
Vendim Nr. 52, datë 01.12.2011  
Vendim Nr. 2, datë 18.02.2013  
Vendim Nr. 60, datë 16.09.2016  
Vendim Nr. 4, datë 14.02.2018

#### Gjykata e Lartë

Vendim Nr. 9, datë 09.03.2006 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë  
Vendim Nr. 3, datë 29.03.2012 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë  
Vendim Nr. 5 datë 30.10.2012 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë

#### Gjykata e Strasburgut

KuoaPoirrez k. Francës, vendim i 30.09.2003, *kërkesa nr.40892/98*  
Fabris k. Francës, Dhomë e Madhe, vendim i 07.02.2013, *kërkesa nr.16574/08*  
X dhe Të tjerët k. Austrisë, Dhomë e Madhe, vendim i 19.02.2013, *kërkesa nr. 19010/07*  
Opuz k. Turqisë, vendim i 09.06.2009, *kërkesa nr. 33401/02*  
*Nanchova dhe Të tjerët k. Bullgarisë*, vendim i 06.07.2005, *kërkesat nr. 43577/98 dhe 43579/98*  
*Thlimmenos k. Greqisë*, Dhomë e Madhe, vendim i 6.04.2000, *kërkesa nr. 34369/97*  
*Çështja Gjuhësore Belge k. Belgjikës*, vendimi i 23.07.1968, *kërkesat nr. 1474/62, 1677/62, 1691/62, 1769/63, 1994/63 dhe 2126/64.*

#### BOTIME

Anastasi, A. (2017). Diskriminimi i Shumëfishtë dhe Roli i Avokatit në Adresimin e tij, *Avokatia*, Nr. 21, Tiranë: Dhoma Kombëtare e Avokatisë.  
Anastasi, A., & Bozo, A., etj. (2016). *Diskriminimi i shumëfishtë dhe mekanizmat ligjorë për parandalimin e tij (Legjislacioni, praktika dhe roli i organizatave jofitimprurëse)*, Tiranë: Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, i aksesuar në 19 Shkurt 2019: [http://www.qag-al.org/publikime/diskriminimi\\_shumefishte.pdf](http://www.qag-al.org/publikime/diskriminimi_shumefishte.pdf).  
Bernard, A. & Mandro, A. & Anastasi, A. (2009). *Çështje të barazisë gjinore në standardet ligjore dhe jurisprudencën kombëtare dhe ndërkombëtare – Udhëzues*. Tiranë: botimet Pegi.  
FundamentalRightsAgencyandCouncilofEurope. (2010). *HandbookonEuropeannon-discriminationlaw*, Luxembourg: Publications Office of the European Union.  
Harris, & O'Boyle&Warbrik. (2014). *The lawof the EuropeanConventionon Human Rights*.UnitedKingdom: OxfordUniversityPress.  
Kotevska, B. *Udhëzues Mbi Bazat e Diskriminimit*. Shkup: Polyesterday.  
Kumbaro, D. (2016). *Përmbledhje e rasteve mbi aftësinë e kufizuar në*

*Jurisprudencën e Gjykatës së Strasburgut*. Tiranë: UNDP.

Mole, N. &Kamber, K. &Liaki, V. (2018). *Drejt një zbatimi efektiv në nivel kombëtar të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*. Beograd: AIRE Centre.

Nowak, M. (2003). *Introduction to the international human rightsregime*. Leiden: BrillAcademicPublishers.

#### BURIME ONLINE:

CommiteeontheEliminationofRacialDiscrimination. *Concludingobservationson the combinedninth to twelfthperiodicreports of Albania, dated 02/01/2019, point C.7, 8, e disponueshme në:*[https://tbinternet.ohchr.org/\\_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CERD/C/ALB/CO/9-12&Lang=En](https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CERD/C/ALB/CO/9-12&Lang=En), 5 mars 2019.  
[https://www.un.org/en/ga/search/vie\\_e\\_doc.asp?symbol=A/RES/217\(III\)](https://www.un.org/en/ga/search/vie_e_doc.asp?symbol=A/RES/217(III))  
<https://rightsinfo.org/explainer-convention-elimination-race-discrimination/> [konsultuar më 08.03.2019].  
<https://www.ohchr.org/EN/HRBodies/CERD/Pages/Membership.aspx> [konsultuar më 08.03.2019].  
<https://www.ohchr.org/en/hrbodies/cescr/pages/cescrindex.aspx> [konsultuar më 08.03.2019].  
<https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/210>[konsultuar më 25.04.2019].  
[file:///C:/Users/kkllapi/Downloads/area-of-justice-and-fundamental-rights\\_eu-accession-to-the-istanbul-convention\\_2019-05-01.pdf](file:///C:/Users/kkllapi/Downloads/area-of-justice-and-fundamental-rights_eu-accession-to-the-istanbul-convention_2019-05-01.pdf)[konsultuar më 25.04.2019].  
[https://www.womenlobby.org/IMG/pdf/ewl-albania\\_report\\_web.pdf](https://www.womenlobby.org/IMG/pdf/ewl-albania_report_web.pdf)[konsultuar më 25.04.2019].



